

**Arsimi  
i lartë**  
Nis transferimi  
i studentëve

Fq.4



**MANASTIR-  
ELBASAN**  
Largpërçuesi  
me Shqipërinë  
gati në 2019

Fq.8



Kriza  
mund  
të sjellë  
divorcin

**Murinjo**

Fq.21



# Koha

www.koha.mk



**Karate në  
vend të  
xhihadit**

Fq.15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3260 · e premte 5 janar, 2018

-1°C | +8°C

15 DEN

## AKTUALE

**Janë krijuar  
parakushte  
për emrin**



Në vitin 2018, janë krijuar parakushte dhe ekziston dritare e mundësisë për zgjidhje, qëndrimi grek është emër i përbërë me përcaktim gjeografik për përdorim të përgjithshëm, ndërsa nëse ka konsensus të gjerë të brendshëm në vend, Kamenos nuk do ta kundërshtojë, thotë ministri pa dikaster dhe zëdhënësi i Qeverisë greke, Dimitris Xanakopoulos, në një intervistë për Euronjuz Greqi. Ai njofton se korrespondenti i MIA-s nga Athina lidhur me linjat e kuqe greke sqaron se ata dihen nga viti 2007 dhe ende janë...

Fq.4

## DOSSIER

**Kërkesa e  
PPD-së dhe  
reagimi i  
Qeverisë së  
RSM-së**

Fq.16-17

## GLOBI

**Fëmijët sirianë  
mbjellin të  
ardhmen**

Fq.15



SHQIPTARËT MJAFTOHEN ME VETËM KATËR MINISTRI

# MAQEDONASIT MILIARDA, SHQIPTARËT MILIONA



Në Buxhetin 2018, për ministrat shqiptarë janë rezervuar shumë më pak para se sa për ministrat maqedonas të LSDM-së. Ministrat shqiptarë lëvizin mes 300 milionë deri në 600 milionë denarë, ndërsa ata maqedonas - vetëm tek Kultura kanë mbi 300 milionë denarë, derisa tek të gjithë të tjerat janë nga një miliard deri tek 43 miliard denarë, aq sa ka Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

Fq.3

## Në dhjetë vite dështojnë 900 milionë euro

Shkup, 4 janar - Në dhjetë vitet e kaluara asnjëherë nuk janë realizuar investimet kapitale në vlerën prej 100 për qind sa janë planifikuar në Buxhetet e fillimit të viteve. Shumat e planifikuara si rëndom janë shkurtuar me rebalanset, ku për shkak të mungesës së parave në buxhet, ose hyrjes të shumë më të vogël në buxhet, të parat që shkurohen me gërshtë kanë qenë investimet kapitale. Bile, edhe shu-

mat e shkurtuara nga rebalancet e buxheteve shpesh nuk janë realizuar në tërësi. Ekonomistët thonë se investime kapitale sjellin zhvillim më të madh ekonomik, krijojnë parakushte për inkurajime të investimeve të huaja dhe investimeve të brendshme. Madje, nëse llogariten shumat që nuk janë investuar si investime kapitale në dhjetë vitet e fundit - del se afër 900 milionë euro nuk janë realizuar...

Fq.9



## LAJMI I FUNDIT

TAKIM I MUNDSHËM  
CIPRAS-ZAEV NË DAVOS

Athinë, 4 janar - Janari është muaji ku pritet zhvillim i ngjarjeve në çështjen për emrin, publikojnë mediat greke dhe këtë qëndrim e mbështesin me takimet e mundshme që do të ndodhin gjatë periudhës së ardhshme. Vizita e zëvendëskryeministrit Bujar Osmani në Athinë, raundi i ri i negociatave për emrin, vizita e sekretarit të përgjithshëm të NATO-s në Shkup dhe takimi eventual i kryeministrave të të dy vendeve në Davos janë aktivitetet e parapara për janar, sipas mediave në Greqi. Duke iu referuar burimeve të tyre, televizionet "Skaj" dhe "Action 24", gazetat "To Vima" dhe "Ta Nea" dhe një pjesë e portaleve informative greke, siç njofton korrespondenti i MIA-s nga Athina, publikuan se të hënën ose të martën zëvendëskryeministri i Maqedonisë, i obliguar për çështje evropiane, Bujar Osmani, do ta vizitojë Athinën dhe do të takohet me shefin e diplomacisë greke, Nikos Koxias dhe zëvendësin e tij, Jorgos Katrugalos. Mediat greke, duke i ndërmarrë informacionet e publikuara në mediat e Maqedonisë dhe, publikuan se për dy javë ndërmjetësuesi Methju Nimic do të mbajë raund të ri të bisedave me përfaqësuesit e dy vendeve, ndërsa më 17 dhe 18 janar në Shkup, pas tre viteve do të vijë sekretari i përgjithshëm i NATO-s. Sipas informatave të pakonfirmuara në mediat greke, nëse ka përparim në bisedat dhe nëse që të dy kryeministrat, edhe Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras shkojnë në Davos, Zvicër, në Forumin ekonomik botëror prej 23 deri 26 janar, atëherë me shumë siguri do të realizojnë edhe takim bilateral. Në Greqi, njofton korrespondenti i MIA-s nga Athina, Maqedonia edhe më tej është "temë e nxehtë", duke marrë parasysh faktin se secila parti ka qëndrim të saj dhe kërkesat e saja. Delegacioni qeveritar është me pozita të ndryshme, SYRIZA kërkon emër të përbërë erga omnes, Grekët e pavarur janë kundër përdorimit të termit Maqedoni në emrin, partitë opozitare kërkojnë një pozitë të vetme dhe të përbashkët nga Qeveria greke, Qeveria greke megjithatë, nga partitë opozitare kërkon qëndrim të qartë nëse do ta përkrahin marrëveshjen eventuale me vendin fqinj.

ZGJIDHJA PËR KISHËN  
E MAQEDONISË VETËM  
PËRMES KISHËS SERBE

Beograd, 4 janar - Kërkesa e kishës maqedonase që ajo bullgare të jetë kishë amë, nuk ka asnjë bazë kanonike dhe historike dhe është dëshmi për mospjekuri", deklaroi patriaku serb Irinej në një intervistë për TV Hram. Sipas tij, zgjidhja e vetme për kishën ortodokse maqedonase është bashkësia me kishën ortodokse serbe. "Nuk dua të lëndoj askënd, po është fakt që atë që e kanë bërë tani me kërkesën ndaj kishës bullgare, nuk ka asnjë bazë kanonike dhe historike dhe është dëshmi për papjekuri. Tregojnë papjekurinë e tyre që të zgjidhin çështjen e tyre, duke mohuar situatën në të cilën gjenden. Problemet mund t'i zgjidhin vetëm në bashkësi me kishën serbe, të cilën e kanë mik të sinqertë, por fatkeqësisht këtë nuk e bënë", tha Irinej. Ai shtoi se i vjen keq për popullin në Maqedoni, pasi sipas tij, është fetar dhe i pastër dhe meriton që kjo çështje të zgjidhet në mënyrën më të mirë.

## BËJENI BREXIT-IN "TORY BREXIT"

"Brexit ka një ndikim masiv shpërqendruar në trajtimin e sfidave aktuale në vend. Votuesve britanikë duhet t'u jepet e drejta që të mendojnë përsëri kur detajet e Brexit-it do të jenë të qarta. Nuk është 'jodemokratike' për të thirrur një votim mbi kushtet e një marrëveshjeje të daljes. Partia Laburiste ka mbështetur rezultatin e referendimit të qershorit në vitin 2016 për të braktisur BE-në, duke nënvizuar se rezultati ishte vullneti i votuesve britanikë. Më mirë të luftojmë për të drejtën e vendit për të rimenduar, të kërkojmë të dimë detajet e plota të marrëdhënies së re para se ta braktisim të vjetrën, e cila kryelartë për të kundërshtuar Brexit-in, shkoni pas partisë Tory për dështimet e tyre për të trajtuar sfidat e vërteta të vendit. Bëjeni Brexit-in 'Tory Brexit'. Bëjeni 100 për qind pjesë të tyre. Tregonu njerëzve pse Brexit-i nuk është, dhe kurrë nuk ishte përgjigjja", shkruan ish-kryeministri britanik Toni Blair në profilin e tij në twitter.

## KINA MES RUSISË, EVROPËS DHE TURQISË

"Në vitet e ardhshme, Kina do të hapë një investim në Ballkan. Fuqitë e tjera tradicionale kanë rritur praninë e tyre gjeopolitike në rajon, veçanërisht Rusia dhe Turqia. Zgjerimi i Kinës do të jetë edhe më i fortë, ende ndryshe në llojin sepse ajo do të jetë një 'penetrim i butë' me më shumë ekonomik. Kjo shtytje do të jetë më e fuqishme në qoftë se Bashkimi Evropian vendos që ta mbajë Ballkanin Perëndimor jashtë BE-së dhe me këtë, do të hap terrenet pjellore për ndërmarrjet kineze. Të tilla si '16 + 1 nisma'. Kështu, dekadën tjetër do të hapet një lloj i ri i vijës gjeopolitike në Ballkan, së bashku me mosmarrëveshjet tradicionale ndëretnike dhe rivalitetit të madh midis Rusisë dhe Perëndimit. Këtë herë beteja do të jetë ekonomike dhe lufta do të jetë mbi kryeqytetin e investimeve kineze. Rusia dhe Turqia do të vazhdojnë të tërheqin rajonin në orbitën e tyre, duke përbushur kundërshtimin nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe BE-së. Kjo lë dhomën e zbrazët për Kinën që të bëjë përparim në modën e tij të qetë. Hapi i parë i Pekinit është që të bëhet një lojtar kryesor ekonomik në Ballkan, ndërsa ndikimi politik do të vijë më vonë. Me vetëm 20 milion banorë, Ballkani Perëndimor nuk përfaqëson një treg të rëndësishëm për prodhimet kineze. Rajoni është më i dobishëm për vendndodhjen e saj. Krahasuar me shitjet e energjisë dhe armëve të Rusisë dhe interesat komerciale të Turqisë, Kina është shumë më e shqetësuar me Ballkanin Perëndimor si një rrugë tranzite për tregun e madh të brendshëm të BE-së", shkruan profesori universitar, Blerim Reka.

PARATË E EMIGRANTËVE, STREHË TEK  
NDËRTUESIT

"Kur ekonomia bazohet tek importi, nuk prodhohet. Kur nuk eksporton prodhime, eksporton trupa emigrantësh. Paratë që emigrantët dërgojnë në vendlindje përdoren për të blerë konsum tek importuesit apo strehë tek ndërtuesit. Importuesit dhe ndërtuesit kanë nevojë për banka që ta eksportojnë ligjëshëm a jashtëligjëshëm paratë e grumbulluar, sërisht jashtë vendit", shkruan në profilin e tij në Facebook, publicisti Arbër Zaimi.

## MEDIACitate

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se pushimin dimëror në Zvicër e ka paguar me para të tij dhe i kanë kushtuar vetëm 7 mijë euro. Mediat kanë raportuar se fundmi se pushimet e kryeministrit në Zvicër, janë ndër më të shtrenjtat dhe se ai qëndroi në një ndër hotelet më të shtrenjta atje. Ai këtë e tha gjatë një vizite në Komunën e Gjakovës, i cili është pritur nga kryetari i kësaj komune Ardian Gjini, me të cilin diskutuan për shumë çështje, si arsimit, sporti, shëndetësia, biznesi.

(Koha Ditore, 4 janar)

Patriarku serb, Irinej tha se Serbia nuk mund të heqë dorë kurrë nga Kosova. "Kosova mund të rrimbehet, të okupohet ashtu siç është sot e okupuar, mirëpo Serbia asnjëherë nuk mund të thotë se po e japim atë, sepse çka jepet me vetdëshirë, nuk mund të merret kurrë më, ndërsa çka merret me forcë, mund të rikthehet po në atë mënyrë" tha lideri i kishës ortodokse serbe në një intervistë për një medium serb. "Me aq sa shoh Serbia po mundohet të gjejë një zgjidhje politike për të mbajtur Kosovën brenda Serbisë, dhe për të kënaqur të dy palët, Serbia pa Kosovën është diçka e paimagjinueshme", shtoi ai.

(lajmi.net, 4 janar)

Problemet brenda lëvizjes "Vetëvendosje" ende po vazhdojnë të mbeten të pazgjidhura. Pas dorëheqjes së Aida Dërgutit nga pozitat drejtuese në LVV, para dy ditësh postet drejtuese në këtë parti i ka lëshuar edhe kryetari i gjertanishëm Visar Ymeri (në shenjë mospajtimi me zhvillimet e fundit). Njohësit e çështjeve politike konsiderojnë se përplasjet e fundit brenda kësaj partie, veçmas dorëheqja e Ymerit, kanë dëshmuar qartë që brenda LVV-së ka dy grupe politike. E një gjë e tillë, sipas tyre, mund të çojë edhe drejt ndarjes përfundimtare të lëvizjes "Vetëvendosje". Nga ana tjetër, përfaqësuesit e këtij subjekti janë shprehur optimistë se do të arrijnë t'i zgjidhin problemet e brendshme, sado që nuk janë pajtuar me rrugën që ka ndjekur Visar Ymeri. "Tersi" brenda LVV-së kishte nisur më 8 dhjetor të vitit të shkuar.

(Gazeta Zëri, 4 janar)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

## KUSH E SHPIKU NË TË VËRTETË TELEFONIN?

Merita i njihet zakonisht shkencëtarit skocez dhe inxhinierit Aleksandër Graham Bell, të cilit iu dha patenta në SHBA për atë që ai e quajti "telegrafi akustik", në vitin 1875. Pretendimi i tij vjen bashkë me historinë e famshme ku Bell e përdor shpikjen e tij për të thirrur kolegun në dhomën ngjitur me fjalët: "Z. Uatson eja këtu - dua të të shoh". Megjithatë, ashtu si me gjithë shpikjet e mëdha, se e kujt është merita ka qenë temë debati, qoftë edhe për atë se çfarë është

saktësisht një "telefon". Për shembull, disa historianë thonë se inxhinieri italian Antonio Meucci dhe shpikësi gjerman Philipp Reis në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri shpikën pajisje të ngjashme me telefonin që arritën të shndërronin tingullin në sinjale elektrike, plot një dekadë më herët. Në vitin 2002, Kongresi i SHBA pranoi se puna e Meucit ishte kaq e rëndësishme, sa që do të kish mjaftuar për të mos i dhënë patentën Bellit.



## SHQIPTARËT MJAFTOHEN ME VETËM KATËR MINISTRI



Për buxhetin e vitit 2018 për ministrat shqiptar janë rezervuar shumë më pak para se sa për ministrat maqedonas të LSDM-së. Ministrat shqiptarë lëvizin mes 300 milionë deri në 600 milionë denarë, ndërsa ata maqedonas - vetëm tek Kultura kanë mbi 300 milionë denarë, derisa tek të gjithë të tjerat janë nga një miliard deri tek 43 miliard denarë, aq sa ka Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

# MAQEDONASIT MILIARDA, SHQIPTARËT MILIONA



LSDM ndonëse me vetëm 49 deputetë, ka më shumë ministri se sa VMRO që kishte 60 deputetë në zgjedhjet e vitit 2011 dhe 55 deputetë në zgjedhjet e vitit 2008

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 4 janar - Me zgjedhjen e ministrit të ri të Shëndetësisë, Venko Filipçe, pozicioni politik i partive shqiptare është ulur ndjeshëm në Qeverinë e Maqedonisë, ndërsa kjo situatë nuk ka qenë që nga zgjedhjet e vitit 2002. Edhe në zgjedhjet e vitit 1994 dhe 1998, shqiptarët kishim më shumë ministri ndonëse nuk ishin të kyçur në administratën shtetërore dhe në organet gjyqësore si pas konfliktit të vitit 2001. Ndërkaq organika e Qeverisë edhe e administratës publike nuk ka ndryshuar nga qeverisja VMRO-BDI. Kjo e fundit mjaftohet me vetëm tre ministri atë të Ekonomisë, Drejtësinë dhe Ministrinë e Ambientit Jetësor, ndërsa RDK udhëheq me Ministrinë e Pushtetit Lokal. Këto ministri, edhe për nga buxheti për vitin 2018 dukshëm kanë më pak para se sa ministrat që udhëheq LSDM, ndërsa njëjtë si në kohën e qeverisjes së VMRO-së, Ministrisë së Ekonomisë nuk i kthehen kompetencat që i ka marrë zëvendëskryeministri për Ekonomi dhe Financa në krye të së cilës është Koço Angjushev. LSDM vazhdon të udhëheq me ministratë më kryesore - atë për Punë të Jashtme, me Punët e Brendshme, Mbrojtjen, Shëndetësinë, Financat, Arsimin, Punën dhe Politikën Sociale, Transportin, Bujqësinë, si dhe me Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës Publike.

Në tre përbërjet e kaluara qeveritare, BDI ka udhëhequr me pesë ministri, ndër to edhe Arsimin gjatë përbërjes qeveritare 2014-2018 dhe 2002-2006, me Ministrinë e Shëndetësisë pas zgjedhjeve të 2008-ës, si dhe me Mbrojtjen pas zgjedhjeve të 2011-



**Shqiptarët nuk dinë se çfarë është të udhëheqësh me Entin Shtetëror të Statistikave, Entin Gjeologjik të Maqedonisë dhe me Arkivin Shtetëror të Maqedonisë - tri organe administrative shtetërore ndër më të rëndësishmet në vend. Kuadro shqiptar nuk udhëheqin as me organet e pavarura shtetërore si Agjencia për Rini dhe Sport, Agjencia për Emigracion, Agjencia për Ushqim dhe Veterinari, si dhe Komisioni për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze**

ës. Në secilën përbërje qeveritare gjatë zgjedhjeve të vitit 2002, 2008, 2011, 2014 dhe ato të fundit 2016 - BDI ka udhëhequr me Ministrinë e Ekonomisë dhe atë të Drejtësisë. E para lë shumë për të

dëshiruar për investime kapitale që prekin interesin shqiptar, ndërsa e dyta po ashtu ka neglizhuar zbardhjen e shumë rasteve të montuara politike dhe vetëm tani në Qeveri me LSDM-në, rasti "Monstra" që u kthye në procedurë gjyqësore nga fillimi, ka shpresë se mund të zbardhet deri në fund. Siç shihet, LSDM ndonëse me vetëm 49 deputetë, ka më shumë ministri se sa VMRO që kishte 60 deputetë në zgjedhjet e vitit 2011 dhe 55 deputetë në zgjedhjet e vitit 2008.

Partitë shqiptare, e më shumë BDI - duket që janë të pafuqishme të realizojnë atë që kishin premtuar para zgjedhjeve të 2016-ës - që Sekretariati për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit të kalojë në Ministri për sistem politik dhe marrëdhënie midis komuniteteve. Ky propozim doli nga Analiza profesionale që iu bë Marrëveshjes së Ohrit nga Instituti Evropian i Paqes dhe ekspertë nga OSBE dhe ekspertë tjerë të pavarur nga organizata joqeveritare. Shqiptarët nuk dinë se çfarë është të udhëheqësh me Entin Shtetëror të Statistikave, Entin Gjeologjik të Maqedonisë dhe me Arkivin Shtetëror të Maqedonisë - tri organe administrative shtetërore ndër më të rëndësishmet në vend. Kuadro shqiptar

nuk udhëheqin as me organet e pavarura shtetërore si Agjencia për Rini dhe Sport, Agjencia për Emigracion, Agjencia për Ushqim dhe Veterinari, si dhe Komisioni për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze. Për momentin, është vakant edhe posti i ministrit pa resor që mbulon Investimet e huaja në vend që më parë udhëhoqi Ramiz Merko, tanimë kryetar i Komunitetit të Strugës.

Kur jemi tek buxheti, ministratë që udhëheqin kuadrot shqiptare kanë buxhet shumë të vogël se sa ato që udhëheqin kuadro maqedonas, si p.sh. Ministria e Ambientit Jetësor ka buxhet 651 milionë e 300 mijë denarë, Ministria e Ekonomisë me 645 milionë e 575 mijë denarë, Pushteti Lokal me 443 milionë e 594 mijë denarë, Ministria e Drejtësisë me vetëm 320 milionë e 896 mijë denarë. Nga sekretariatet, ai për çështje evropiane në krye me Bujar Osmanin ka buxhetin më të vogël nga të gjithë resorët qeveritar - edhe atë vetëm 105 milionë e 459 mijë denarë, ndërsa Sekretariati për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit ka buxhet prej 641 milionë e 400 mijë denarëve.

Nga ana tjetër, ministratë që udhëheqin kuadro të LSDM-së arrijnë shifra qindfish më të larta se

sa ato që udhëheqin kuadrot shqiptare, madje deri në 43 miliard e 602.533 milionë denar që janë paraparë për Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale. Mbi 1 miliard denar kanë edhe këto ministri: Ministria e Arsimit me 25 miliard e 179.444 milionë denar, Shëndetësia me 6 miliard e 674 milionë denarë, Ministria e Punëve të Brendshme me 10 miliardë e 241 milionë denarë, Ministria e Mbrojtjes 6 miliardë e 500 milionë denarë, Ministria për Transport dhe Lidhje me 6 miliard e 71 milionë denarë, Ministria e Financave me 2 miliard e 271 milionë denar, Ministria e Punëve të Jashtme me 1 miliard e 181 milionë denar, Ministria e Bujqësisë me 1 miliard e 172 milionë denar, Ministria e Informatikës dhe Administratës Publike me 1 miliard e 472 milionë denar. Vetëm Ministria e Kulturës me 353 milionë e 645 mijë denarë dhe Sekretariati për çështje ekonomike me 105 milionë e 450 mijë denarë, me të cilët udhëheq LSDM, janë në nivel të njëjtë me resorët qeveritar që udhëheqin shqiptarët. Në përqindje sa i përket sferave shoqërore prin Sigurimi Social dhe Mbrojtja e Fëmijëve me 32 për qind, zhvillimi ekonomik dhe puna e financave me 19 për qind, shëndetësia 14 për qind, arsimit, shkencat dhe sporti 11 për qind, siguria dhe rendi publik 5 për qind, ndërtimtaria, transporti, komunikimet dhe ekologjia 5 për qind, bujqësia 5 për qind, mbrojtja 3 për qind, Punë të Jashtme dhe eurointegritet 2 për qind, kultura 2 për qind, gjyqësori 1 për qind, si dhe zhvillimi rajonal 1 për qind. Diskriminimi nuk është vetëm tek ministratë, por edhe në organet tjera shtetërore dhe po aq i dukshëm është edhe në Universitetet publike.

## QEVERIA DO TË DEBATOJË PËR SHUMË LIGJE

Qeveria do të mbajë seancë në të cilën mes të tjerash do ta shqyrtojë informacionin për të lidhur marrëveshje me Këshillin e Ministrave të Shqipërisë për bashkëpunim në rast të katastrofave. Në rend dite të seancës së 47-të është edhe informacioni për miratimin e Planit të azhurnuar implementues kombëtar për reduktim dhe eliminim të ndotësve të vazhdueshëm organik në vend. Para ministrave do të gjenden edhe propozim ndryshimet e Ligjit për Avokatin e

Popullit, si dhe ndryshimet e Ligjit për menaxhim me pronën e konfiskuar, dobënë pronësore dhe lëndë të marra në procedurë penale dhe kundërvajtëse. Qeveria do ta shqyrtojë edhe informacionin për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve në drejtim të përmirësimit të punës efektive të institucioneve ndëshkuese-përmirësuese, ndërsa nga sfera e shëndetësisë do të shqyrtohen propozim-ndryshimet e Ligjit për ilaçe dhe mjete mjekësore.

## NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË



## NIS TRANSFERIMI I STUDENTËVE

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 4 janar - Transferimi i studentëve nga njëri universitet në tjetrin, fakultet apo program studimor tanimë ka filluar edhe zyrtarisht. Që me mbylljen e ligjëratave për semestrin e parë të vitit akademik 2017/2018, institucionet e arsimit të lartë kanë çel afatet e rregullta për transferimin e studentëve, respektivisht të kredive të studimit që ata mund ti bartin nga një program i caktuar studimor në tjetrin. Kjo lëvizje e studentëve, e cila mundësohet nga ECTS-ja, pra Sistemi Evropian i Transferim të Kredive të Studimit, është kthyer prej vitesh në një vlerë sublime të arsimit të lartë dhe një përparësi për studentët. Provime

apo vite të kaluara me sukses, që me zbatimin e Procesit të Bolonjës në arsimin e lartë konvertohen në kredi të fituara nga ana e studentëve, nuk shkojnë dëm.

Pa pasur nevojën e përsëritjes së atyre provimeve, kandidati që për arsye të ndryshme dëshiron të ndryshojë Programin e studimeve apo edhe universitetin, i bartë me vete komplet kreditë që i ka fituar paraprakisht. Të njëjtat i njihen sikur ti ketë fituar te Programi i ri dhe, nëse ka nevojë prej vitit të ardhshëm, studenti mund të kthehet te Programi i parë apo edhe të transferohet te një program ose universitet krejtësisht i ri. Për këtë mjafton që asnjëri prej atyre programeve të mos ketë pasur probleme me akreditimin. Në

të kundërtën, transferimi nuk mund të kryhet. ECTS, sikurse shpjegon Ibrahim Neziri, nga zyra për çështje arsimore në Universitetin e Tetovës, përpos tjerave - është edhe një arsye më shumë që obligon universitetet të jenë të vëmendshme me afatet e akreditimit të programeve studimore. Një prej vërtetimeve që duhet të disponojnë studentët në dosjen e transferimit është edhe vërtetimi për lejen e akreditimit të Programit ku studenti ka fituar kreditë e pretenduara. Pastaj, në kuadër të këshillave mësimore të fakulteteve mirëprirëse, formohen komisione të cilat verifikojnë dhe miratojnë sasinë e kredive të pranuar. Konkursi për transferim, sa i përket UT-së, është gati që në datën 29 dhjetor të

vitit të kaluar. "Konkursi përfshin secilin studentë që është i regjistruar diku tjetër dhe dëshiron që ato studime ti transferojë në universitetin tonë. Kjo është e mundshme në bazë të Ligjit, pasi të gjithë kanë mundësi ti transferojë studimet ku të dëshirojnë. Kjo është një mundësi shumë e mirë për studentët që të kenë mundësi të përjetojnë përvoja të tjera, të ndryshojë programin studimor, fakultetin dhe nëse ka nevojë - edhe shtetin", shprehet Neziri. Koha e aplikimit për transfer, thotë se është e limituar edhe atë nga 22 deri 31 janari.

Në muajin shkurt, pra pasi të mbyllet afati i aplikimeve, do të nis edhe procesimi i njohjes së kredive. "Ky proces bëhet nga komisione

Nga 22 deri 31 janari, të gjitha studentët që për arsye të ndryshme kanë vendosur të ndryshojnë programin e studimit, fakultetin apo edhe universitetin, mund të aplikojnë për transferin e kredive. Në UT, konkursi është gati që javën e kaluar



IBRAHIM NEZIRI

**Konkursi përfshin secilin studentë që është i regjistruar diku tjetër dhe dëshiron që ato studime ti transferojë në universitetin tonë. Kjo është e mundshme në bazë të Ligjit, pasi të gjithë kanë mundësi ti transferojë studimet ku të dëshirojnë. Kjo është një mundësi shumë e mirë për studentët që të kenë mundësi të përjetojnë përvoja të tjera, të ndryshojë programin studimor, fakultetin dhe nëse ka nevojë - edhe shtetin**



## ATHINA I VLERËSON MUNDËSITË PËR ZGJIDHJEN E KONTESTIT ME MAQEDONINË

## JANË KRIJUAR PARAKUSHTE PËR EMRIN

"Mendoj se ajo që është e rëndësishme në këtë fazë është fakti që edhe kryeministri grek dhe lideri i IRJM-së, qartë kanë deklaruar se mund të krijojnë parakushte politike dhe ekziston vullneti i përbashkët që të gjejmë zgjidhje të pranueshme për të dy palët. Mendoj se kjo është ajo që duhet ta mbajmë në këtë fazë", thotë Dimitris Xanakopoulos

Athinë, 4 janar - Në vitin 2018, janë krijuar parakushte dhe ekziston dritare e mundësisë për zgjidhje, qëndrimi grek është emër i përbërë me përcaktim gjeografik për përdorim të përgjithshëm, ndërsa nëse ka konsensus të gjerë të brendshëm në vend, Kamenos nuk do ta kundërshtojë, thotë ministri pa dikaster dhe zëdhënësi i Qeverisë greke, Dimitris Xanakopoulos, në një intervistë për Euronjuz Greqi.

Ai njofton se korrespondenti i MIA-s nga Athina lidhur me linjat e kuqe greke sqaron se ata dihen nga viti 2007 dhe ende janë në fuqi. "Qeveria greke, si edhe periudhën e kaluar, në negociatë do të vijë pikërisht me këtë qëndrim politik, gjegjësisht emrin e përbërë me përcaktim gjeografik dhe validitet të emrit ndaj të

gjithëve. Prej këtu ekzistojnë edhe çështje të tjera për të cilat duhet të bisedohet. Megjithatë për momentin, nuk dua të ndërhyjë në hollësi teknike. Mendoj se ajo që është e rëndësishme në këtë fazë është fakti që edhe kryeministri grek dhe lideri i IRJM-së, qartë kanë deklaruar se mund të krijojnë parakushte politike dhe ekziston vullneti i përbashkët që të gjejmë zgjidhje të pranueshme për të dy palët. Mendoj se kjo është ajo që duhet ta mbajmë në këtë fazë", thotë Dimitris Xanakopoulos. Në intervistën për Euronjuz Greqi, zëdhënësi i Qeverisë greke, e përsërit të njëjtën, siç publikoi MIA pardje, e tha duke folur për TV ERT-in shtetëror, se në vitin 2018 mund të gjendet zgjidhje për emrin. "Mendoj se në vitin 2018 janë krijuar

disa parakushte, që të jemi optimist se do të mundemi të gjejmë

zgjidhje të ndërsjellë të pranueshme në suaza të emrit të

përbërë, sepse edhe vendi fqinj hoqi dorë prej disa qëndrimeve

## OSMANI: DO TË JU INFORMOJ ME KOHË PËR VIZITËN NË ATHINË

Zëvendëskryeministri i angazhuar për Çështje Evropiane, Bujar Osmani dje deklaroi se me kohë dhe zyrtarisht do të kumtohet, kur do të kontraktohet vizita në Athinë. Duke iu referuar burimeve të veta, televizionet "Skaj" dhe "Action 24", gazetat "To Vima" dhe "Ta nea" dhe disa nga portalet informative greke, lajmëron korrespondenti i MIA-s nga Athina, kumtuan se të hënën apo të martën Osmani, do ta vizitojë Athinën dhe do të takohet me shefin e diplomacisë greke, Nikos Koxias dhe zëvendësin e tij, Jorgos Katrugalos. "Kemi komunikim të vazhdueshëm me Republikën e Greqisë, me kryeministrin Aleksis Cipras, me ministrin e Punëve të Jashtme, Nikos Koxias. Ai komunikim do të vazhdojë edhe më tej, do të ketë edhe takime të rregullta gjatë periudhës në vijim. Në

kushte të animozitetit dhe mospasjes së komunikimit nuk mundet të pritët zgjidhje e kontestit me Greqinë, krijuam ura, secila vizitë në Athinë apo Shkup është një urë më tepër", tha Osmani pas takimit të sotëm joformal me ambasadorin bullgar në vend, Ivan Velikov Petkov, pa dashur konkretisht të thotë nëse të hënën do ta vizitojë Athinën. Ai dhe Petkov patën takim joformal lidhur me kryesimin bullgar me Bashkimin Evropian në gjashtë muajt e ardhshëm. Në pyetjen nëse insistohet për referendum lidhur me çështjen për emrin, Osmani thekson se kjo zgjidhje ka disa hapa dhe se duhet të fillohet nga i pari, e jo të shkohet në të tretin apo të katërtin. "Së pari të gjejmë zgjidhje, më pas do të flasim se si do ta verifikojmë", tha Osmani.

profesionale të fakulteteve përkatëse, të cilat vendosin se cilat prej kredive të programit paraparak janë të vlefshme (pra njihen) për programin e ri, kuptohet në bazë të përmbajtjes së lëndëve, ngarkesës së punës që duhet të realizojë studenti. Në fund silltet vendimi për njohjen e lëndëve (kredive)", pohon përgjegjësi i zyrës për çështje arsimore në UT. Sistemi i Bolonjës dhe ECTS kanë pikërisht këtë përparësi, pra mobilitetin dhe transferon e kredive. "Studenti i cili ka kryer një aktivitet të caktuar në një program studimor nuk ka nevojë ta kryejë të njëjtin në programin tjetër, pasi kreditë e fituara barten dhe transferohen falë ECTS-së", sqaron më tej Neziri.

Zyra për çështje arsimore, e cila është në ingerencat e Prorektorit për çështje arsimore, përveç se me aplikimet e transferimeve të gjitha tipave, merret edhe me menaxhimin e orareve të provimeve, kolokviumeve, plan-programeve, parakushteve për dëgjimin e lëndëve, caktimin e takimeve me koordinatoret e ECTS-së, mban kontakte dhe lëshon vendime të caktuara për studentët që dëshirojnë të konfirmojnë kualifikimet e fituara, kreditë e tyre, e kështu me radhë. Këtu menaxhohet edhe çështja e studentëve të huaj, respektivisht mobiliteti konform procedurave juridike. Me një fjalë, kjo zyrë merret me trajtimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me studentët në të gjitha etapat, nga marrja e atij statusi deri ditën e diplomimit.

radikale nga e kaluara, dhe nga ana greke ekziston vullnet, disponim të ecim para drejt zgjidhjes së problemit. Vlerësimi ynë është se në të vërtetë, ekziston dritare për mundësinë në vitin 2018 edhe qëllimi ynë është të ndërtojmë sa është e mundur konsensus më të madh të brendshëm që të mund të ecim para drejt zgjidhjes së problemit konkret", sqaron Xanakopulos. Lidhur me qëndrimin e kundërt të partnerit të koalicionit Grekët e Pavarur, zëdhënësi qeveritar thotë se deklaratat e Panos Kamenos në asnjë rast nuk e përjashtojnë mundësinë për të gjetje të zgjidhjes. "Kamenos mori qëndrim shumë përgjegjës, duke thënë këtë, se përveç asaj që është i përmbajtur për çështjen konkrete, nuk është në disponim të shkaktojë krizë qeveritare, politike, përkundrazi si kusht e vendos atë që e thashë paraparakisht, konsensus më i madh i mundur në suaza të sistemit politik. Nëse arrihet kjo", Kamenos tha se nuk do ta kundërshtojë zgjidhjen e kësaj çështje, thotë zëdhënësi i Qeverisë greke, transmeton MIA. Lidhur me takimin eventuale të liderëve të partive politike për zgjidhjen e emrit, Xanakopulos thotë se periudhën e ardhshme do të dihen edhe hapat e ardhshëm të Qeverisë.

SHILEGOV ZOTOHET SE PUNON PËR ELIMINIMIN E NDOTJES SË AJRIT

# BASHKË KUNDËR NDOTJES

"Çdoherë do të jem në front pavarësisht asaj se sa do t'i kushtojë rejtingut tim politik në luftën kundër ajrit të ndotur. Unë nuk do të jem kryetar komune, i cili do t'ju ftojë t'i mbyllni dritaret dhe me siguri e shikoni se mund të shihet ky dallim", theksoi Shilegov

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 4 janar - Kryetari i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov, deklaroi se do ta mbështesë tubimin protestues "Protestë për ajër të pastër", i paralajmëruar në rrjetet sociale. Tubimi do të mbahet pasdite para Qytetit të Shkupit. "Do të dal për shkak se unë e ndaj shqetësimin e njëjtë si edhe çdo banor i Shkupit. Unë e thith të njëjtin ajër siç e thithin edhe ata njerëz. Do të jem me ta dhe do t'i ftoj tek unë në zyrë, të bisedojmë për problemet. Çdoherë mund të vihet deri në ide të mirë nga çdo bashkëqytetar i ynë. Qyteti punon me përkushtim dhe tanimë ndër-morëm një seri serioze e masave urgjente intervenuese. Më shumë se 140 milionë denarë pikërisht sivjet dedikohen pikërisht për mbrojtjen e mjedisit jetësor, që deri tani nuk ishte e paraparë", tha Shilegov. Ai paralajmëroi se në pranverë do të fillojnë me gjelbërim intensiv të Shkupit. Sipas tij, nevojitet që të gjithë bashkërisht, MPB në pjesën e komunikacionit, MMJPH në pjesën e inspektimit të kapaciteteve të cilët janë në qytet, ndërsa janë nën kompetencë të tyre, si Makstill, Usje..., ta përforcojnë mbikëqyrjen inspektuese me qëllim që, siç tha, të kemi me të vërtetë ajër të shëndetshëm ambiental së shpejti. "Çdoherë do të jem në front pavarësisht asaj se sa do t'i kushtojë rejtingut tim politik në luftën kundër ajrit të ndotur. Unë nuk do të jem kryetar komune i cili do t'ju ftojë t'i mbyllni dritaret dhe me siguri e shikoni se mund të shihet ky dallim", theksoi Shilegov. Ai përkujtoi se nga Viti i Ri në rajonin qendror të qytetit ka regjim të posaçëm të komunikacionit për dër-



## BUXHET MË I MADH PËR MJEDISIN JETËSOR

Inspektorati Shtetëror për Mjedis Jetësor për vitin 2018 planifikon furnizimin e pajisjeve për matje indikative dhe krahasuese me laborator të akredituar për mjedis jetësor, vendosjen e bazës së plotë të të dhënave për vlerësimin e rrezikut, ueb faqen e re, përfundimin e resurseve njerëzore dhe përpunimin e strategjisë për zbatimin e legjislaturës nëpër rajonet planore. Buxheti i Inspektoratit për vitin 2018 është rritur për 60 për qind në 24,7 milionë denarë, ndërsa programin vjetor për punën e inspektoratit, dje e prezantoi drejtori i ISHMJ, Miroslav Bogdanovski. "Theksi

kryesor i është vënë planifikimit dhe frekuentimit të mbikëqyrjeve inspektuese. Qëllimi është çdo subjekt industrial i nënshtruar në mbikëqyrje të bëjë analizë të veçantë të rrezikut me çka do të optimizohet numri i mbikëqyrjeve dhe do të veprohet në mënyrë parandaluese", deklaroi Bogdanovski. Fokusi i mbikëqyrjeve për vitin 2018, theksoi Bogdanovski, ka të bëjë me industrinë që bën pjesë në lejet e integruara A si çimentorja, rafineria, ngrohtoret dhe objektet e mëdha industriale, menaxhimi i mbeturinave, zonat e mbrojtura dhe ujërat.

gesë të mallit deri te dyqanet. Sipas tij, çdo segment i vogël kontribuon që të kemi për një nuancë ajër më cilësor. "Kjo do të jetë beteje e gjatë dhe e lodhshme, por unë jam i bindur se do ta fitojmë si qytetarë të Shkupit. Mos-hyrja e rreth 4.000 mini automjeteve transportuese për dërgesë të mallit në rajonin qendror të qytetit kontribuon në mënyrë të sigurt që të zvogëlohet kaosi i komunikacionit gjatë ditës dhe ka kontribut të tij", vlerësoi Shilegov. Në pyetjen e gazetarëve për qentë endacakë, Shilegov përkujtoi se Qyteti i Shkupit në bashkëpunim me

Shoqatën për mbrojtje të kafshëve "Anima mundi" përgatiti raport të posaçëm i cili iu prezantua opinionionit. Theksoi se në 17 faqe janë paraparë hapat për këtë problem, ndërsa në buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2018 janë paraparë më shumë se 10 milionë denarë për këtë çështje, shumë e cila është jashtë shpenzimeve vijuese të NP "Higjiena komunale". "Kjo është shumë e cila deri tani nuk është ndarë. Fillojmë në mënyrë sistematike ta zgjidhim problemin me qëllim që në një afat të mesëm Qyteti i Shkupit më nuk do të ketë problem me qentë en-

dacak", tha Shilegov. I pyetur për itinerarin dimëror të NPQ Shkup, Shilegov tha se kjo praktikohet në Shkup më shumë se 20 vite. "Në ditët kur vendosim masa të jashtëzakonshme, është rritur vëllimi i autobusëve dhe është falas transporti. Sektori i komunikacionit në Qytetin e Shkupit punon në përpunimin e studimit për koncept të ri të transportit urban për shkak se Shkupi definitivisht ka transport urban publik shumë të vjetruar", tha Shilegov pas hapjes së Muzeut të punëtorive ilegale për përpunim të armëve në Shkup gjatë LNÇ-së.

## 8500 EURO GJOBË PËR DEPONINË "DRISLLA"

Konform ligjit për cilësi të ajrit ambiental është ngritur procedurë kundërvajtëse dhe kufizim të punës së subjektit juridik deponia "Drislla" për shkak të tejkalimit të regjistruar të kufijve të lejuar për lëshim të inceleratorit, gjegjësisht furrës për djegie të mbeturinave mjekësore, informoi në konferencën e sotme për shtyp drejtori i Inspektoratit Shtetëror për Mjedis Jetësor, Miroslav Bogdanovski. "Gjoha varion deri në 25 mijë euro. Komisioni kundërvajtës solli vendim kontraktuar që deponia të dënohet me 8.500 euro. Veprohet rreth Ligjit për ajër ambiental. Kanë udhëzime në afat prej 90

ditëve të vendosin filtra dhe ta zgjidhin problemin", tha Bogdanovski. I pyetur nëse në periudhën prej 90 ditëve do të digjet mbeturinë mjekësore në "Drislla", Bogdanovski tha se deponia guxon të djegë vetëm tetë orë në ditë, jo në tre turne, siç ka qenë deri më tani, kur atë e lejojnë kushtet e motit. "Domethënë, pse nuk kemi variant rezervë për atë mbeturinë mjekësore dhe mund të shkaktohet problem shumë më i madh në lidhje me deponimin dhe veprimin me të. Mbeturina e plotë mjekësore nga Maqedonia dërgohet në "Drislla" dhe mund të bëhet problem i madh", tha Bogdanovski.

## NË FILLIM TË VITIT, DY VIKTIMA NË KOMUNIKACION



## 2018 NISI KEQ

Autoritet policore kanë njoftuar se gjatë ditës së mërkurë, në akset rrugore në Tetovë dhe Kërçovë, kanë ndodhur dy aksidente komunikacion, me çka kanë ndërruar jetë dy persona

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 4 janar - Fillimi i vitit 2018 për sigurinë në komunikacion aspak nuk është treguar i mire. Për vetëm katër ditë që kur kemi hyrë në vitin e ri kalendarik, nëpër akse të ndryshme rrugore janë regjistruar të vdekur dhe dhjetëra të lënduar në aksidente komunikacion. Përveç lëndimeve të lehta dhe të rënda trupore, dëmeve materiale dhe krijimit të kaosit në komunikacion, gjatë ditëve të kaluar u regjistruan edhe dy aksidente me pasoja fatale. Ndonëse këta dy aksidente fatale ndodhën në lokacion të ndryshme, element i përbashkët në këto dy raste është se gjatë përplasjeve së veturave, kanë marrë pjesë automjete me targa të huaja. Trendi negativ i përfshirjes së "gurbetçarëve" në aksidente rrugore në vendlindje, fatkeqësisht përsëritet vit pas viti. Një fenomen i tillë, ndonëse me tepër është prezent gjatë periudhës së verës, kur fluksi mysafirëve nga jashtë është më i madhe, megjithatë sipas ngjarjeve të fundit aksidente e tilla janë shpeshtuar edhe në këtë periudhë të vitit. Autoritet policore, gjatë raportimit për çështjen e sigurisë në komunikacion, kanë njoftuar se gjatë ditës së mërkurë (3 janar), në akset rrugore në Tetovë dhe Kërçovë, kanë ndodhur dy aksidente komunikacion, me çka kanë ndërruar jetë dy persona. Në njoftimin zyrtar të Ministrisë për Punë të Brendshme, theksojnë se gjatë orës 17:20, të datës 3 janar, në aksin rrugor Kërçovë-Makedonski Brod, me fshatrave Sërbanin dhe Staroec, ka ndodhur një aksident mes dy veturave, njëri me targa të Ohrit e tjetri me targa Sllovene.

"Në këtë aksidente kanë marrë pjesë tre automjete. Vetura e tipit 'Golf' e drejtuar nga A.D nga Kërçova, vetura tjetër ka qenë e llojit 'Alfa Romeo' të cilën e ka drejtuar personi M.S nga fshati Pllasnicë dhe kamioni i cili ka qenë i përfshirë në aksidente ka qenë i drejtuar nga personi D.D

nga Kërçova. Në vend ngjarje, nga lëndime e pranuar, ka nderuar jetë një foshnje tre mujore. Përderisa me lëndime të rënda trupore kanë kaluar drejtuesi e veturave, njëri prej të cilëve për shkak të seriozitet të plagëve është dërguar në spitalin e Ohrit. Mes tjerash lëndime të lehta në këtë aksidente ka marrë një fëmijë i moshës 13 vjeçare", thonë nga MPB-ja. Rasti tjetër tragjik i cili ndodhi gjatë ditëve të kaluar, si rezultat i të cilit u krijua një kaos i vërtet në magjistralen Shkup-Gostivar, u regjistruar në hyrje të fshatit Kamjanë (aksi Tetovë-Gostivar).

"Një veturë me targa të Tetovës dhe tjetra me targa të Zvicrës, janë përfshi në këtë aksident rrugor. Në këtë aksidente me lëndime të rënda trupore ka kaluar shoferi nga Tetova, i cili në veturë ka qenë i shoqëruar nga bashkeshortja e cila në vend ngjarje ka

nderuar jetë. Dhe pesë pasagjer tjerë të cilët kanë marrë lëndime të lehta trupore", njoftojnë nga policia e Tetovës. Në të dyja këto ngjarje fatale, siç njoftojnë organet e rendit, ekspertizë në vend ngjarje ka kryer prokurori publik. Me qëllim zbardhjen e plotë të rastit dhe vërtetimit të shkaqeve që kanë çuar deri te këto aksidente, nga policia kanë theksuar se janë duke punuar dhe se më kohë opinionin do të njoftohet për të gjitha zhvillimet. Shpejtësia e madhe dhe mos përmbajtja e rregullave të komunikacion, sipas raporteve të Këshillit Republikan për Siguri në Komunikacion (KRSK), paraqesin shkaqet më të shpeshta se pse ndodhin aksidente në komunikacion, me çka një pjese tyre me pasoja tragjike. Ndryshe, vitin e kaluar në Maqedoni, nëpër lokacione të ndryshme rrugore janë regjistruar mbi 124 aksidente komunikacion me pasoja tragjike.

## ZBARDH RASTI I AKSIDENTIT NË TË CILIN E HUMBI JETËN FOSHINJA TREMUJJSHE

Me urdhër të prokurorit publik nga Prokuroria Themelore Publike Kërçovë janë mbledhur gjurmë nga vendi i aksidentit që ka ndodhur dje në rrugën Kërçovë-Makedonski Brod në të cilën jetën e ka humbur një foshnje tremuajshe. Vizion ekspertizë e tyre, si dhe ekspertiza teknike në trafik për konfirmimin e rrethanave për ngjarjen, kumtoi PPRM-ja. Aksidenti ka ndodhur dje rreth orës 17:00 në rrugën magjistrale Kërçovë-Makedonski Brod në të cilën jetën e ka humbur një foshnje tremuajshe, ndërsa pesë persona janë lënduar rëndë. Menjëherë pas aksidentit, prokurori publik në kujdestari nga PTHP Kërçovë dhe ekipi mbikëqyrës nga MPB-ja kanë kryer inspektim në vendin e ngjarjes. Sipas

informacioneve të para, siç është theksuar në kumtesën e Prokurorisë, aksidenti ka ndodhur kur shoferi i automjetit motorik të udhëtarëve i markës "Golf" me targa të Ohrit që ka lëvizur nga Makedonski Brod drejt Kërçovës, ka tentuar për ta tejkaluar automjetin transportues - me tërheqje i markës TAV me targa të Kërçovës. Gjatë tejkalimit, automjeti Golf është përplasur në automjetin motorik "Alfa Romeo" me targa të Sllovenisë, që vinte nga ana e kundërt. Në vendin e ngjarjes nga lëndimet e marra ka ndërruar jetë foshnja tremuajshe. Udhëtarët e dy automjeteve motorike me lëndime të rënda trupore janë transferuar në institucionet mjekësore për dhënien e ndihmës së mëtutjeshme

## KRONIKË

## Hidhet me gurë treni në afërsi të "Shkup-Veri"

Persona të panjohur kanë gjuajtur me gurë një tren transportues në afërsi të stacionit hekurudhor "Shkup-Veri". Treni ka qarkulluar në relacionin vendkalimi kufitar "Bllacë" - stacioni hekurudhor "Trubarevë". Nuk ka persona të lënduar. "Në polici është denoncuar se mes stacionit hekurudhor "Gjorqe Petrov" dhe stacionit hekurudhor "Shkup-Veri", më saktë në sinjalin hyrës të stacionit hekurudhor "Shkup-Veri", persona të panjohur kanë hedhur me gurë një tren transportues, i cili ka qarkulluar në relacionin vendkalimi kufitar "Bllacë" - stacioni hekurudhor "Trubarevë", informojnë nga MPB-ja. Nga atje theksojnë se punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

## Vjedhje e rëndë në një banesë në Shkup

Një kryerës i panjohur nga një banesë në Shkup ka vjedhur sasi më të madhe të stolisë së arit dhe argjendit në vlerë prej rreth 400.000 denarë. Gjatë kryerjes së vjedhjes ai ka shkakuar edhe dëme materiale prej rreth 3.000 denarë. Rastin në polici e ka denoncuar R.V.(63) nga Shkupi, pronar i banesës e cila ndodhet në rrugën "Peklane". Ai e ka informuar policinë se vjedhja ka ndodhur dje në periudhën nga ora 16 deri në orën 21:30. "Kryerësi me përdorim të forcës dhe vegël përkatëse e ka hapur derën e tarracës, ka hyrë brenda dhe ka marrë sasi më të madhe të stolisë së arit dhe argjendit, me ç'rast ka ikur në drejtim të panjohur. Në këtë mënyrë autori ka përfituar dobi pronësore kundërligjore prej rreth 400.000 denarë, ndërsa ka shkakuar edhe dëme materiale prej rreth 3.000 denarësh. Po ndërmerren masa për gjetje të kryerësit dhe për ndriçim të rastit", informojnë nga MPB-ja.

## Interpol me urdhër arrest për 5 të dyshuarit për ngjarjet në Kuvend

Pesë shtetas të Maqedonisë kërkohen me urdhër arrest ndërkombëtar të Interpolit lidhur me ngjarjet e 27 prillit të vitit të kaluar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Siç është publikuar në uebfaqen e MPB-së, nga dje me urdhër arrest ndërkombëtar kërkohen Nikolla Mitrevski - Kolo, Aleksandar Vasilevski - Ninxa, Mlladen Dodeski, Dean Davidovski dhe Mitre Pitropovski. Ata ngarkohen me veprën "rrezikim terrorist të rendit kushtetues dhe sigurisë" lidhur me ngjarjet e 27 prillit në Kuvend. Deri tani kërkoheshin vetëm me urdhër arreste vendore. Gjykatat në mungesë të tyre u caktoi masë paraburgim, ndërsa sapo të gjenden menjëherë do të dërgohen në Burgun hetues në Shuto Orizarë. (O.Xh)

“Nga 1 janari këtij viti, të gjithë qytetarët që kanë realizuar të hyra plotësuese përveç rrogës mujore gjatë vitit 2017, do të duhet deri të DHP apo në sportelet e drejtorisë ku ata jetojnë, personalisht të dorëzojnë formularin e plotësuar për tatimin personal vjetor”, thotë Novaković

DERI MË 15 MARS AFATI PËR PARAQITJEN E TË HYRAVE PLOTËSUESE

# 200 EURO GJOBË NËSE NUK DORËZOHET FORMULARI



më 31.12. 2017, përveç pagës mujore - kanë realizuar të hyra tjera plotësuese. Bujqit, të cilët përveç të hyrave nga veprimtaria si bujk individual kanë realizuar edhe të hyra plotësuese, qytetarët të cilët kanë të hyra nga veprimtaria individuale ndërsa kanë realizuar edhe të hyra tjera plotësuese, qytetarët të cilët realizojnë të hyra nga dhënia e pronave të patundshme me qira siç janë toka bujqësore, hapësira afariste apo banimi, si dhe qytetarët që realizojnë të hyra nga të drejtat autoriale, gjithashtu janë të obliguar të dorëzojnë formularin për tatim vjetor personal. Në bazë të Ligjit për Tatim Personal, formular për tatimin vjetor duhet të dorëzojnë edhe ata qytetarë që kanë të hyra nga kapitali si dividendat dhe të gjithë ata që kanë të realizuar të hyra nga shitja e pronave të patundshme. Formularin për tatimin vjetor personal duhet dorëzojnë edhe ata qytetarë që kanë realizuar të hyra nga lojërat e fatit. Ndërkaq, sipas Ligjit për Tatimin Personal, nuk duhet të paraqesin formular ata persona që brenda një viti të hyra kanë pasur vetëm rrogën mujore, pensionin dhe ata që ushtrojnë veprimtari individuale dhe nuk kanë realizuar të hyra plotësuese.

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 4 janar - Duke filluar nga 1 janari e deri më 15 mars të këtij viti, të gjithë qytetarët që kanë realizuar të hyra plotësuese përveç rrogës mujore, obligohen të plotësojnë formularin për tatim personal vjetor dhe të njëjtin ta dorëzojnë deri të Drejtoria për të Hyra Publike. Kështu thotë zëdhënësja e DHP-së, Vesna Novaković, e cila paralajmëron se ligji parasheh gjoba nga 100 deri në 200 euro për ata që nuk e respektojnë afatin kohor dhe nuk dorëzojnë formular. “Nga 1 janari këtij viti, të gjithë qytetarët që kanë realizuar të hyra plotësuese përveç rrogës mujore gjatë vitit 2017, do të duhet deri të DHP apo në sportelet e drejtorisë ku ata jetojnë, personalisht të dorëzojnë formularin e plotësuar për tatimin personal vjetor”, thotë Novaković, e cila përgënjeshtro

lajmet e publikuara kohë më parë se vet DHP është ajo që qytetarëve do t'u dorëzojë formularë të plotësuar me të gjitha të dhënat, ndërsa qytetarët vetëm duhet ti verifikojnë të dhënat e plotësuar paraprakisht nga DHP. “Informatat e plasura më parë se DHP plotëson formularët ndërsa qytetarët vetëm i verifikojnë të dhënat, nuk janë të vërteta. Bëhet fjalë për keqinterpretim nga disa media dhe portale. Qytetarët nuk do të duhet të dorëzojnë formularin për tatimin personal nga janari i vitit

2019. Prandaj, edhe këtë vit është obligim i vetë qytetarëve që të dorëzojnë deri te DHP-ja formularët për tatimit personal vjetor të plotësuar nga vetë ata”, sqaron Novaković. Në të kundërtën, shprehet zëdhënësja e DHP-së, nëse qytetarët nuk do të dorëzojnë formularin e plotësuar për tatimin vjetor personal, do të dënohen me nga 100 deri më 200 euro në kundërvlerë të denarit. “Obliguesit tatimor që nuk do të dorëzojnë në afatin e paraparë deri më 15 mars të vitit 2018 formularin e plotësuar për ta-

timin vjetor personal, do të gjobiten me gjoba prej 100 deri më 200 euro në kundërvlerë në denarë për shkak se kanë bërë shkelje të Ligjit për Tatim Personal”, thotë Novaković, e cila njëherësh shton se mos plotësimi i formularëve nga ana e qytetarëve vlen nga 1 janari i vitit 2019, e jo siç u raportua paraprakisht nga 1 janari i vitit 2018.

Ndryshe, formularin për tatim vjetor personal duhet ta plotësojnë dhe dorëzojnë të gjithë qytetarët që brenda një viti kalendarit apo nga 1 janari i vitit 2017 e deri

## Mbi 1.8 milionë kartela pagesore shfrytëzohen në Maqedoni

Shkup, 4 janar - Mbi 1.8 milionë kartela pagesore shfrytëzojnë qytetarët në Maqedoni. Pjesa më e madhe e shfrytëzuesve janë persona fizikë, ndërsa nga brendet më e përfaqësuar është “Viza”. Të dhënat e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë tregojnë se gjithsej kanë lëshuar 1.862.240 kartela pagesore, nga të cilat personat fizikë shfrytëzojnë 1.830.948, ndërsa personat juridikë 31.292 kartela. Për dallim nga shifra e madhe e kartelave pagesore, gjithsej në Maqedoni ka lëshuar kartela për blerje në internet 19.348, nga të cilat të personave fizikë janë 19.300, ndërsa 48 të personave juridikë. Nga gjithsej kartelat e lëshuara, kreditore janë 372.413 nga të cilat 362.591 janë të personave fizikë, ndërsa 9.532 janë të personave juridikë. Funkcion debitor kanë 1.442.072 kartela. Më shumë nga kartelat e lëshuara janë të brendit “Viza” 1.096.707, të “Masterkard” bëjnë pjesë 667.907 kartela dhe brendet tjera janë të përfaqësuar me 78.278 kartela.

NJË LIGJ I RI I MINISTRISË SË FINANCEVE

## NJË SOFTUER QË DO T'I NDJEKË BORXHLINJTË

Shkup, 4 janar - Ministria e Financave përpunoi softuer, ku të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë do të duhet t'i plotësojnë obligimet e tyre të papaguara. Në këtë mënyrë do të ketë mbikëqyrje të vazhdueshme të obligimeve në kohë reale. Ligji i cili e mundëson këtë, veçmë është përgatitur, paralajmëroi ministri i Financave, Dragan Tevdovski, në intervistë për TVM-në. Tevdovski thotë se rreth 360 milionë euro obligime të papaguara, por të fshehura nga ana e institucioneve publike, të cilat e kanë trashëguar, është sasi serioze e obligimeve të mbledhura, nëse merret parasysh se deficieti i Maqedonisë është rreth 300 milionë euro. “Puna e dytë që është shumë me rëndësi është se ne kemi arritur për kohë të shkurtë një pjesë të atyre obligimeve t'i paguajmë. Për shembull, për Filarmoninë, e cila është hapur me shumë pompozitet, praktikisht ka pasur borxhe serioze të papaguara, të mbetura nga pushteti i kaluar. Ne ato borxhe arritëm në pjesën më të madhe t'i paguajmë”, thotë ai në intervistë. Tevdovski potencoi se hapja e transparencës është hap kyç, pasi me këtë opinionin do të ketë mbikëqyrje në harxhimin e parave dhe do të mund të bëjë presion nëse



dikush nuk i harxhon paratë ashtu siç duhet. “Unë personalisht mendoj se transparencja është hapi i parë në normalizimin dhe stabilizimin e gjendjeve në Maqedoni. Jo vetëm në ekonomi, por edhe në përgjithësi”, vlerëson ai. Lidhur me rritjen e projektuar të ekonomisë prej 3,2 për qind për këtë vit, Tevdovski thotë se është real. “Stabilizimi i gjendjes politike së bashku me kthimin e besimit të investuesve duhet të kontribuojë për rritjen e investimeve private. Kjo është ajo që na mungoi viteve të kaluara që kjo të mundësohet. Për herë të parë në Buxhet ka përkrahje serioze,

para së gjithash për ndërmarrjet e vendit krahas atyre të huaja. Përkrahja përfshin përkrahje për investime, për hapjen e vendeve të reja të punës. Ky është një këndvështrim, i dyti është, që ta kthejmë kredibilitetin dhe besimin te investitorët, MF shumë fuqishëm punoi në transparencën”, sqaron Tevdovski. Lidhur me realizimin e investimeve kapitale, të cilat këtë vit në buxhet janë 400 milionë euro, Tevdovski thotë se Ministria e Financave do të bëjë presion të fuqishëm që investimet kapitale të realizohen, pasi kjo do ta lëvizë ekonominë.

Nga MEPSO gjithashtu informojnë se për këtë projekt - deri më tani janë përpiluar disa dokumente dhe të gjitha rezultojnë se i njëjti është tepër i leverdishëm si për Maqedoninë dhe Shqipërinë, ashtu edhe për rajonin e gjerë

SË SHPEJTI FILLOJNË PUNIMET PËR NDËRTIMIN E LINJËS SË RE MANASTIR-ELBASAN

# LARGPËRÇUESI ME SHQIPËRINË GATI NË 2019



me përvojë disa vjeçare në fushën e ndërtimit të largpërçuesve. "Kruna Drill", kompania vendore pjesë e këtij projekti, thonë në MEPSO, është trashëguese e kompanisë shtetërore "Enti gjeologjik" dhe ka përvojë të begatshme sa i përket drejtimit të makinerive të ndryshme për punë ndërtimore, ndërsa kompania e huaj shtetërore nga Hungaria "MVM Ovit" ka përvojë 60 vjeçare në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e trafostacioneve të tensionit të lartë.

Nga MEPSO gjithashtu informojnë se për këtë projekt - deri më tani janë përpiluar disa dokumente dhe të gjitha rezultojnë se i njëjti është tepër i leverdishëm si për Maqedoninë dhe Shqipërinë, ashtu edhe për rajonin e gjerë. "Ndërtimi i këtij largpërçuesi do të kontribuojë për një rrjet shpërndarës më të mirë dhe më të fuqishëm të energjisë elektrike në Maqedoninë Lindje-Perëndim, si dhe furnizim më të sigurt të energjisë elektrike.

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 4 janar - Ndërtimi i largpërçuesit drejt Shqipërisë po shkon drejt realizimit. Se ky largpërçues është i rëndësishëm së veçantë jo vetëm për dy shtetet fqinje, por edhe për gjithë rajonin sa i përket furnizimit të sigurt me energji elektrike, e thonë edhe nga operatori maqedonas i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike - MEPSO. Kjo e fundit tani më ka nënshkruar marrëveshje me "MVM Ovit", kompani shtetërore hungareze dhe kompaninë nga Maqedonia "Kruna Drill" për fillimin e punëve për ndërtimin e

linjës së re 400 KW të interkonjeksionit, e cila do të lidhë Maqedoninë dhe Shqipërinë mes qytetit të Manastirit dhe Elbasanit. Ky projekt, sipas MEPSO-s, do të realizohet deri në vitin 2019, e cila njëherësh është iniciativë e Komisionit Evropian (KE) dhe e financuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) me kredi në vlerë prej 37 milionë euro e që ka qëllim kryesor krijimin e një korridori portativ lindje-perëndim të energjisë elektrike

përmes Bullgarisë, Maqedonisë, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Italisë, përfshirë kabllon e planifikuar nënujore nga Mali i Zi në drejtim të Italisë. Madje, MEPSO thotë se kompanitë të cilat duhet të ndërtojnë largpërçuesin janë kompani

VAZHDON SHQYRTIMI I PROJEKTEVE ME INTERES NACIONAL

## EDHE DY JAVË PRITJE PËR PROGRAMIN NACIONAL

Volumi i aplikimeve, kriteret dhe formati i ndryshuar i konkurrimit, janë disa prej arsyeve kryesore që të zhvendosen limitet kohore për shqyrtimin e projekteve nga një muaj, në dy. Në Ministrinë e Kulturës pohojnë se grupet e punës janë duke punuar intensivisht, ndërsa shpallja e rezultateve mund të bëhet në mesin e muajit janar. Botime, muzikë, dramë janë sektorët ku edhe këtë vit numërohen më shumë projekte për kulturën shqiptare



Koha Evis HALILI

Shkup, 4 janar - Rezultatet e konkurseve për Programin nacional të kulturës nuk janë gati. Në Ministrinë e Kulturës vazhdon shqyrtimi i projekteve të dorëzuara një muaj e gjysmë më parë në shtatë veprimtaritë arte vizuale, arkitekturë e dizajn; folklor e mu-

zikë, dramë; literaturë e botime; projekte interdisiplinare; trashëgimia; veprimtaria ndërkombëtare. Volumi i aplikimeve, kriteret dhe formati i ndryshuar i konkurrimit, janë disa prej arsyeve kryesore që të zhvendosen limitet kohore për shqyrtimin e projekteve nga një muaj, në dy. I unifikuar dhe i thjeshtëzuar, sipas

rregullave dhe kriterëve të reja që i përshtaten nevojave dhe kërkesave të atyre që merren me kulturë, u cilësua ky konkurs, për të cilin Ministria e Kulturës paralelisht zhvilloi edhe tre sesioneve informative për të sqaruar aplikantët. Në Ministrinë e Kulturës pohojnë se grupet e punës janë duke punuar intensivisht,

ndërsa shpallja e rezultateve mund të bëhet në mesin e muajit janar. Risi në transparencën e rezultateve këtë vit krahas informacioneve për projektin do të jetë edhe publikimi i shumave me të cilat do të mbështetet çdo projekt në veçanti.

Pritjet për Programin e sivjetshëm janë më të mëdha, jo vetëm për shkak të riformatimit të konkurseve në veçanti, por edhe për fondin me të cilin ky institucion ka planifikuar për të financuar veprimtaritë kulturore. Gjatë prezantimit të buxhetit për vitin 2018 ministri i Kulturës Robert Alagjovovski bëri me dije se për financimin e sektorëve dhe projekteve në kulturë për vitin 2018 parashikohen mbi 200 milionë denarë më tepër sesa një vit më parë. Konkretisht sa i takon financimit të drejtpërdrejtë të veprimtarive, aktivitetet e sektorit të dramës janë të parat sa i takon përqindjes 23% krahasuar me buxhetin e vitit 2017 (mbi 471 milionë denarë). Më pas është sektori i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore (mbi 437 milionë denarë), si edhe veprimtaria skenike dhe



Njëherësh, interkonjeksioni i tensionit të lartë do të mundësojë përkrahje të përbashkët midis Shqipërisë dhe Maqedonisë për plotësimin e nevojave të energjisë elektrike për hidrocentralet e Shqipërisë dhe centraleve termale në Maqedoni", thonë nga MEPSO. Njëherësh, përmendin në MEPSO, interkonjeksioni midis Manastirit dhe Elbasanit dukshëm do të kontribuojë edhe në kontekstin rajonal, sepse ky largpërçues do të përmirësojë sigurinë e rrjetit rajonal të energjisë, si dhe siguri të plotë të furnizimit me energji elektrike vendet e rajonit. "Linja e re prej 400 KW e interkonjeksionit do të përmirëson rrjetin për furnizim të energjisë elektrike, duke rritur kështu kapacitetin për lidhje direkte me burimet e reja energjetike në Ballkan. Ndërtimi i këtij projekti të madh paraqet pjesën e fundit të realizimit të Korridorit 8 në kontekstin e krijimit të korridorit lindje-perëndim për shpërndarjen e energjisë elektrike midis Bullgarisë, Maqedonisë, Shqipërisë dhe Italisë", thonë nga MEPSO. Paratë për ndërtimin e largpërçuesit Manastir-Elbasan janë siguruar në fillim të vitit 2016, kur MEPSO nënshkroi marrëveshjen me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për kredi në vlerë prej 37 milionë eurosh. Ndërtimi i largpërçuesit në territorin e Shqipërisë do të kushtojë 24.6 milionë euro dhe sipas MEPSO-s, edhe Shqipëria tashmë i ka të siguruar këto mjete.

artin muzikor (mbi 347 milionë denarë), e të tjera. Nga ana tjetër, një tjetër rregull i ri për seleksionimin e projekteve do të jetë cilësia si kriter bazë. Sipas paralajmërimeve nga ky institucion shifrat do të kalojnë në plan të dytë dhe projektet do të miratohen jo për të shtuar përqindjen, por për të shtuar cilësinë.

Botime, muzikë, dramë janë sektorët ku edhe këtë vit numërohen më shumë projekte për kulturën shqiptare.

Në ministri bëjnë me dije se interesimi është më i madh në këto veprimtari dhe pritet që edhe projektet në mbështetje të kulturës shqiptare do të jenë më të shumta në programin e këtij viti. Buxheti i këtij viti i kushton një rëndësi mbështetjes së aktiviteteve që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe shprehjeve të reja artistike, sektorë këto që vitet e kaluara janë mbështetur pak ose aspak nga buxheti i ministrisë. Financimi i aktiviteteve për integrimin evropian ka siguruar një fond prej 20 milionë denarë (90% më shumë).

Ndërsa risi janë shprehjet e reja multidisiplinore, ndërdisiplinore dhe moderne artistike, për të cilat është akorduar një fond prej 28 milionë denarë. Edhe fondet e dedikuara për mbështetjen e talenteve të reja për këtë vit janë dyfishuar.

## INVESTIMET KAPITALE ASNJËHERË NUK REALIZOHEN DERI NË FUND



### INVESTIMET KAPITALE DHE REALIZIMI SIPAS VITEVE

2010:	86.65 për qind
2011:	84.37 për qind
2012:	87.50 për qind
2013:	82.42 për qind
2014:	83.58 për qind
2015:	83.96 për qind
2016:	76.01 për qind
2017:	83.60 për qind

# NË DHJETË VITE DËSHTOJNË 900 MILIONË EURO

Sipas rekomandimeve të Bankës Botërore, shtetet në zhvillim duhet të ndajnë së paku 20 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto apo afër 1.8 miliardë euro në rastin e Maqedonisë, e cila ndan më pak se 5 për qind të PBB-së për investime kapitale

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 4 janar - Në dhjetë vitet e kaluara asnjëherë nuk janë realizuar investimet kapitale në vlerën prej 100 për qind sa janë planifikuar në Buxhetet e fillimit të viteve. Shumat e planifikuara si rëndom janë shkurtuar me rebalanset, ku për shkak të mungesës së parave në buxhet, ose hyrjes të shumës më të vogël në buxhet, të parat që shkurohen me gërrshëri kanë qenë investimet kapitale. Bile, edhe shumat e shkurtuara nga rebalancet e buxheteve shpesh nuk janë realizuar në tërësi. Ekonomistët thonë se investime kapitale sjellin zhvillim më të madh ekonomik, krijojnë parakushte për inkurajime të investimeve të huaja dhe investimeve të brendshme. Madje, nëse llogariten shumat që nuk janë investuar si investime kapitale në dhjetë vitet e fundit - del se afër 900 milionë euro nuk janë realizuar tërësisht. Nga ana tjetër, edhe një pjesë e caktuar e investimeve kapitale nuk kanë sjellë efekt shtesë dhe afatgjatë për ekonominë, pasi janë investuar në projekte joproduktive siç ishte "Shkupi 2014".

Në ndërkohë, institucionet e ndryshme ndërkombëtare financiare sugjerojnë që shtetet në zhvillim të rrisin të hollat për projekte të ndryshme infrastrukturore, ndërsa kërkojnë të ulin gradualisht të hollat për paga, pensione, mallra dhe shërbime. Sipas reko-

mandimeve të Bankës Botërore, shtetet në zhvillim duhet të ndajnë së paku 20 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto apo afër 1.8 miliardë euro në rastin e Maqedonisë, e cila ndan më pak se 5 për qind të PBB-së për investime kapitale. Në favor të realizimit më të suksesshëm të investimeve kapitale, nga Oda Ekonomike e Maqedonisë kanë kërkuar nga ekzekutivi i ri, analizë tremujore sa se janë realizuar në praktikë investimet kapitale.

Në ndërkohë, në vitin 2017 janë realizuar 83.6 për qind e investimeve kapitale ose 19.8 miliardë denarë në të holla. Deri në fund të muajit nëntor realizimi i tyre ka arritur në 60 për qind, por në muajin dhjetor është rritur dukshëm realizimi i tyre - kryesisht si rrjedhojë e realizimit me 96 për qind të Fondeve IPA. Me buxhetin e vitit 2018 parashikohen të harxhohen afër 400 milionë euro investime kapitale, apo 20 milionë euro më shumë se në vitin 2017.

"Investimet kapitale janë parashikuar në nivelin prej 24.144 milionë denarë dhe janë të dedikuara për intensifikimin e projekteve infrastrukturore si përfundimi i Korridorit 10 dhe infrastrukturës hekurudhore, infrastrukturës energjetike dhe komunale, si dhe investimeve kapitale për përmirësimin e sistemit shëndetësor, arsimor, social, shëndetësi, kulturë, sport, mbrojtje të ambientit dhe gjyqë-

sor", thuhet në arsyetimin e Buxhetit.

Në Buxhetin e ri parashikohen edhe harxhime kapitale në shumën prej 3.556 milionë denarë për modernizimin e rrugëve dhe hekurudhës, ku pritet përfundimi i aksit rrugor Demit Kapi-Smokvicë që do të kompletojë Korridorin 10. Do të investohet edhe në infrastrukturën energjetike dhe komunale në shumë prej 5.898 milionë denarë, ku do të vazhdohen punimet në gazsjellësin Shtip-Negotinë-Manastir dhe Shkup-Tetovë-Gostivar.

Përmes Fondeve IPA do të përkrahjet ndërtimi i stacioneve filtruese për ujërat e zeza në Kërçovë, Prilep, Radovish dhe Strumicë, si dhe rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në Kumanovë, Berovë dhe Prilep. Në rregullimin e Zonave industriale - do të investohen 441 milionë denarë. Për sheshin "Skënderbeu" në Shkup parashikohen 125.000.000 denarë, ndërsa për projektin për mbrojtje ekologjike të lumit Radika gjithsej 51.700.000 denarë.

Mjete parashikohen edhe për përmirësimin e furnizimit me ujë në Gostivar, Radovish dhe Kavadar. Nga ana tjetër, janë parashikuar edhe 75.000.000 denarë për sistemin e furnizimit me ujë në Komunën Sopište që përfshin edhe fshatin Patishka Rekë dhe 20.000.000 denarë për kanalizimin dhe ujësjellësin në Zonën e Vizbegut. Mjete prej 1.852.000.000 denarë para-

shikohen edhe për Hidrosistemin Raven-Reçicë, digën në Sllupçan, rehabilitimin e pompës në Dibër dhe ndërtimin e digave në lumin e Orizares dhe digës Konsko. Në ndërtimin dhe rikonstruimin e spitaleve do të investohen 1.859 milionë denarë, mjete nga Buxheti dhe nga kredi të ndryshme. Mjetet ndër të tjerash do të ndahen për furnizimin me pajisje mjekësore dhe rikonstruimin e Spitalit në Kërçovë. Në vitin 2018 do të fillojnë aktivitetet për ndërtimin, rikonstruimin dhe rindërtimin e Qendrës Klinike "Nëna Terezë" në Shkup, si dhe do të vazhdojë implementimi i Spitalit rajonal klinik në Shtip, i financuar me borxh nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës.

Për ndërtimin dhe rikonstruimin e shkollave, çerdheve, sallave sportive, konvikteve dhe pajisjen e universiteteve do të harxhohen 2.440 milionë denarë. Në ndërkohë, 2.604 milionë denarë janë të parashikuara për bujqësi, vaditje dhe zhvillim rural. Me kredi të jashtme do të mbështetet realizimi i fazës së dytë dhe të tretë të sistemit Zletovica për vaditjen e 4.570 hektarëve tokë në komunat Shtip dhe Probishtip, dhe hidrocentraleve të vogla përgjatë rrjedhës së lumit Zletovica. Do të mbështetet edhe vaditja e lumit Vallandovë. Gjithashtu, përmes mjeteve IPA do të rehabilitohen dhe mbindërtohet rrjeti i kanalizimit në Shkup, Kërçovë, Manastir, Tetovë etj.

FENOMENI QË U SHNDËRRUA NË SHQETËSIM GLOBAL

## TEKNOLOGJIA PO MBYT FOTOGRAFINË NË LETËR!



Me përparmin e teknologjisë, posaçërisht përsosmërisë së kamerave të telefonave celular, gjithnjë e më shumë po humb tradita e printimit apo shtypjes në letër të fotografive. Ky fenomen shqetësues është bërë problem global, thonë ekspertët e fotografisë. Përparimi i teknologjisë, postimi i shpejtë i fotove nëpër rrjete sociale po bën ata të jenë foto momentale e rrallëherë mbeten kujtime. Një gabim i vogël teknik, një buton i shtypur pa dashje - megjithatë i dërgon në histori fotot tuaja...

Koha

Aida XHONI

Shkup, 4 janar - Epoka e digjitalizimit dhe globalizmi po bëjnë që të harrohen shpesh rrënjët e zhvillimit njerëzor. Kështu po ndodh edhe me shpikjet e mëdha siç është fotografia, që përbën njërin ndër arritjet më të mëdha të shkencës për njerëzimin ndër shekuj, pasi me anë të saj - dihet se u arrit dokumentimi dhe trajtimi artistik i natyrës njerëzore - dhe jo vetëm ashtu siç ajo paraqitet në origjinal. Kështu ndodh që shumëkush edhe sot e kësaj dite, megjithëse i vetëdijshëm për avancimin e botës digjitale e kompjuterike, nuk preferon të bëjë foto me kamera të tilla, sado të lartë të kenë rezolucionin e pamjes. Bota e kamerave filmike duket në zhdukje e sipër, por profesionistët e vërtetë dinë ta ruajnë e ta vlerësojnë akoma me të njëjtën dashuri fotografimin. Me përparmin e teknologjisë, posaçërisht përsosmërisë së kamerave të telefonave celular, gjithnjë e më shumë po humb tradita e printimit apo shtypjes në letër të fotografive. Ky fenomen shqetësues është bërë problem global, thonë ekspertët e fotografisë. Përparimi i teknologjisë, postimi i shpejtë i fotove nëpër rrjete... po bën ata të jenë foto-momentale e rrallëherë mbeten kujtime. Një gabim i vogël teknik, një buton i shtypur pa dashje - dërgon fotot tuaja në histori. Arben Sulejmani, fotograf i njohur nga Shkupi, njëherësh edhe pronar i foto-studio "Beni", njëra ndër më të njohurat në kryeqytet, thotë se "raporti njëherësh bujar midis cilësisë së figurës dhe çmimit u zvogëluar në kufijtë e papërfillshëm".



ARBEN SULEJMANI

**Raporti, njëherësh bujar midis cilësisë së figurës dhe çmimit u zvogëluar në kufijtë e papërfillshëm pasi teknologjia, mediat sociale dhe interneti në përgjithësi na bombardojnë me një sasi kaq tronditëse të informacionit vizual që sytë tanë shpesh janë të mpirë dhe ne mezi nuk jemi më në gjendje të tregojmë fotografimin e mirë**

"Fotografimi digjital lejon të eksperimentosh dhe të marrësh me të vërtetë shanse. Sfidat megjithatë është - era digjitale i kthen të gjithë në një fotograf. Raporti, njëherësh bujar midis cilësisë së figurës dhe çmimit u zvogë-



BESIM SEJDIU

**Të gjithë ne çdo ditë bëjmë foto të reja me telefon ose ndonjë aparat digjital e të njëjtat i harrojmë me ndonjë hard-disk. I mbushim disqet dhe njëkohësisht harrojmë se mundësia që të digjet hard-drive ose prishja e tyre rrezikon edhe humbjen e atyre fotove të cilat i kemi të regjistruara**

lua në kufijtë e papërfillshëm pasi teknologjia, mediat sociale dhe interneti në përgjithësi na bombardojnë me një sasi kaq tronditëse të informacionit vizual që sytë tanë shpesh janë të mpirë dhe ne mezi nuk jemi më në gjendje të tre-



FARUK SHEHU

**Njeriu që ka shije dhe stil nuk mund të krahasoj fotografimin në letër dhe një tjetër fotografi që është digjitale. Personalisht për mua, fotografia në letër e ka vlerën e veçantë dhe është një moment që mund të të fus në dimensione të ndryshme të mendimeve. Fizikisht e shoh fotografimin në letër, por psikikisht e ndjej një tjetër kënaqësi**

gojmë fotografimin e mirë, pavarësisht nga më pak të mira. Fotografia e mirë, megjithatë, është e njëjta punë e vjetër e vështirë siç ishte në të kaluarën. Ajo kërkon durim, përkushtim, kreativitet. Nëse ju jeni një fotograf më tradicional, fo-

tografia e mirë është ende e njëjtë. Është duke e dokumentuar të tashmen duke prodhuar një interpretim artistik të saj", thotë Sulejmani. Besim Sejdiu, me profesion drejtor fotografie dhe fotografi Faruk Shehu, në një prononcim për gazetën KOHA e vlerësojnë si shqetësues faktin e humbjes së traditës për printimin e fotografive. Teknologjia po e vret printimin e fotografisë, thotë Sejdiu.

"Veçse ka humb, rrallë dikush printon fotografi, përveç se në dasma si duket aty ende është tradicionale të printohen. Teknologjia e ka mbytur me njëfarë mënyre printimin e fotografisë. Fotot me telefon, të cilat i bën me mijëra, i poston nëpër rrjete sociale dhe i harron që ekzistojnë, ndërsa fotot e printuara i ke gjatë tërë jetës dhe e kanë vlerën e vet. Të gjithë ne çdo ditë bëjmë foto të reja me telefon ose ndonjë aparat digjital e të njëjtat i harrojmë me ndonjë hard-disk. I mbushim disqet dhe njëkohësisht harrojmë se mundësia që të digjet hard-drive ose prishja e tyre rrezikon edhe humbjen e atyre fotove të cilat i kemi të regjistruara", tha Sejdiu. Ai që ka stil, shije dhe shpirt artisti nuk e harron vlerën e fotografisë në letër, shprehet fotografi Faruk Shehu.

"Sa i përket vlerës së fotografive të shtypura në letër, mendoj se prapë se prapë njeriu që ka shije dhe stil nuk mund të krahasoj fotografimin në letër dhe një tjetër fotografi që është digjitale. Personalisht për mua, fotografia në letër e ka vlerën e veçantë dhe është një moment që mund të të fus në dimensione të ndryshme të mendimeve. Fizikisht e shoh fotografimin në letër, por psikikisht e ndjej një tjetër kë-

## REVOLUCIONI DIGJITAL DHE FOTOGRAFIA

**Përbën fillimin dhe fundin e kësaj historie. Bëhet fjalë për revolucionin digjital. Elektronizimi i gjithanshëm ka bërë të mundur që edhe fotoaparartet të bëhen gjithnjë e më komode. Më 1963, firma "Canon" prezantoi aparatën e parë automatik. Pas dhjetë vjetëve, pasoi aparat plotësisht elektronik nga "Rollei", me të cilin mund të editoheshin ngjyrat, "dritaret" etj. Nga fundi i shekullit të kaluar, e gjithë teknika fotografike u revolucionarizua edhe njëherë përmes digjitalizimit. Tani jo vetëm që fotot mund të ruheshin si material filmik, por edhe në**

**formate digjitale. Kjo është e lirë dhe e lehtëson punën me to. Mund të kontrollohet direkt dhe mund të fshihet menjëherë. Interneti po ashtu e lehtësoi shkëmbimin e fotove, të cilat dërgohen si dokumente. Softuaret për përpunimin e fotove po ashtu lehtësojnë përpunimin dhe mundësojnë përmirësimin e gabimeve në foto. Sot, çdo njeri me anë të një softuari të thjeshtë mund të përmirësojë fotot e kujtimet e veta, e madje t'i manipulojë ato. Mund të krijosh albume online e të përdorësh karta memorie që arrijnë të mbajnë me qindra foto-imazhe etj.**

naqësi. Teknologjia e bën të veten, dinamika e jetës, mundësitë teknologjike sa të duash... sikur në film që thash - varet prej njeriut, ai që ka stil, shije dhe shpirt artistik nuk e harron vlerën fotografisë së shtypur. Por për fat të keq, nëse shikojmë pak më gjerë - shumë pak njerëz nuk e kanë harruar vlerën e fotografisë së shtypur", u shpreh Shehu. Qytetarët e anketuar me mendime të ndara, disa veçojnë momentet më të mira të vitit dhe në fundvit e rrumbullakojnë me një album fotografite më të mira e disa nuk e shohin të arsyeshme printimin e tyre. "Fotografite kanë shumë rëndësi për mua dhe për çdo vit - printoj nga 100 më të mirat, sepse nuk i besoj shume teknologjisë dhe ka mundësi të më humbin, në letër jam më i sigurt, sidomos pas lindjes së vajzës e cila tash i ka 3 vjet e gjysmë, pas çdo ditëlindje të saj - printojmë 100 fotot më të mira të vitit", tha Hasim Memishi, aktor.

"Prej momentit që kanë dalë telefonat celularë me kamerë, aparatet digjitale, nuk kemi shtypur fotografi. Sigurisht që vlen të shtypen se çdo kujtim i shtypur në letër është më afatgjatë, por ja si duket jeta dinamike nuk na ka lënë shumë kohë të mendojmë për të ndarë kohë për t'u përkushtuar në shtypjen e fotografive", tha Bleranda Xh. "Nuk e mbaj mend kur kam shkuar në foto-studio për të printuar fotografi. Të printohen fotot s'e shoh aq të arsyeshme se çdo gjë tashmë është e kompjuterizuar... vetëm në raste ma te veçanta kur ndonjë foto ka ma shumë rëndësi", tha Ermal Kaja, student.

#### GJENEZA E FOTOGRAFISË

Rrënjët e saj u takojnë kontributeve të dy francezëve - Nicephor Niepce dhe Louis Daguerre, të cilët konsiderohen si zbuluesit e fotografisë. Ata zhvilluan teknikën e parë dhe procesin kimik, që mundësonte kësaj ruajtjen e pamjeve. Më pas, erdhën dekada të tëra me zhvillime teknike. Me prezantimin e parë të aparatit "Kodak" në vitin 1889, ky zhvillim arriti një pikë, të themi kulmore e të qenësishme, e cila është arritur të mbahet gjallë deri më sot.



DALLIME TË MËDHA NË PAGESË TË KONTRIBUTEVE PËR SIGURIM SHËNDETËSOR

# PAGUAJNË MË PAK, SHFRYTËZOJNË MË SHUMË!

Përkundër faktit se në Maqedoni, 95 për qind e popullatës kanë sigurim shëndetësor, megjithatë ka dallime të mëdha midis kontributeve shëndetësore që paguan shteti dhe kontributeve që paguajnë të punësuarit, gjegjësisht kontributet shëndetësore që shteti u paguan në muaj "të varfërve" janë shumë më të ulta kundrejt shërbimeve që i shfrytëzojnë këta persona

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 4 janar - Sigurimi Shëndetësor në Maqedoni është gjithëpërfshirës dhe rreth 95 për qind e qytetarëve shfrytëzojnë të drejtën e shërbimeve shëndetësore, megjithatë ka dallime të mëdha midis kontributeve shëndetësore që i paguajnë shtetit dhe atyre që falas marrin po këto shërbime shëndetësore. Studimi i fundit i titulluar temë "Shëndetësia midis presioneve fiskale për investime më të mëdha dhe nevoja për shëndet më të mirë të qytetarëve", përgatitur në kuadër të projektit për transparencë fiskale dhe përgjegjësi për përmirësimin e politikave në fushat siç janë përmirësimin e cilësisë së jetës, arsimit dhe shëndetësisë - FISCAT, tregon se megjithatë, Maqedonia tashmë ka arritur të stabilizojë sigurimin universal shëndetësor. Sipas Maja Parnarxhieve Zmejtkova ish drejtore e Fondin për Sigurim Shëndetësor njëherit autore e këtij studimi Analizat që dalin nga studimi sipas Parnarxhieve përfshin të dhëna për atë sa qytetarët kanë sigurim shëndetësor, çfarë shërbime marrin për sigurim, si të avancohet sistemi i sigurimit shëndetësor dhe të minimizohen dobësitë. "Rezultatet tregojnë se Maqedonia ka krijuar një sigurim universal shëndetësor, duke u mundësuar të drejtën të gjithë popullsisë për t'u siguruar, dhe tani për tani - këtë të drejtë e shfrytëzojnë më shumë se 95 për qind popullatës. Duke



analizuar Rregulloren dhe të dhënat që kishim në dispozicion, u identifikuan katër grupe personash që nuk mbulohen nga sigurimi shëndetësor. Sfidë për shtetin në të ardhmen më tej mbeten 500 persona që nuk kanë dokumente personale, dhe për këto njerëz shteti duhet të gjejë një mënyrë për t'ju mundësuar atyre sigurim shëndetësor", thotë Maja Parnarxhieve-Zmejtkova, ish-drejtoresh e Fondit për Sigurim Shëndetësor në Maqedoni, ndërsa shprehet se ka dallim të madh në numrat e personave të paraqitur si të varfër me qëllim që shteti t'ua paguajë sigurimin dhe numrit statistikor të personave të varfër. "Kjo do të thotë se në vitin 2015, paraqitet një dallim prej 19.062 personave që janë të siguruar si të varfër dhe personat që jetojnë nën pragun e varfërisë, apo më shumë persona janë të siguruar si të varfër dhe për këta - shteti financon sigurimin shëndetësor se sa për personat që jetojnë në Maqedoni nën pragun e varfërisë. Kontributet për personat e varfër të përfshirë në sigurim shëndetësor universal paguhet 5.4 për qind nga paga mesatare. Këto kontribute sigurohen nga Buxheti i shtetit dhe paguhet çdo muaj në emër të më shumë se 250.000 qytetarëve", thotë Parnarxhieve Zmejtkova. Ajo më tej zbulon se ky studim mund të jetë një udhërrëfyes për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Financave se si të avancojnë sigurimin universal shëndetësor në Maqedoni, gjegjësisht tejkalimin e dobësive të identifikuar, duke arritur financimin më të drejtë të sistemit të kujdesit shëndetësor. "Analizat në këtë studim kanë për qëllim që në mënyrë transparente, ato pjesë të cilat janë probleme qenësore në sistemin shëndetësor - të propozojë

zgjdhje të cilat do të ndihmojnë që në të ardhmen sistemi shëndetësor në Maqedoni të jetë më i mirë. Partecipimi si mekanizëm kontrollues për shërbimet në sistemin shëndetësor në Maqedoni është i përcaktuar në 20 për qind nga vlera e përgjithshme e shërbimit shëndetësor dhe analizat në këtë pjesë tregojnë se mesatarisht 5.6 për qind nga çmimi i shërbimeve shëndetësore apo mbi 300 mijë siguroes në vit i shfrytëzojnë këto benefite. Studimi njehërësh nxjerr në pah se një pjesë e madhe e këtyre kontributeve, sidomos kontributet që ua paguan shteti dhe kontributet që paguajnë personat e punësuar, 49 për qind



**Një bujk mesatarisht për kontribute shëndetësore në muaj paguan më pak, ndërsa shfrytëzon më shumë shërbime shëndetësore. Në anën tjetër, një i punësuar paguan më shumë kontribute për sigurim shëndetësor ndërsa shfrytëzon më pak shërbime shëndetësore. Një bujk brenda një muaji paguan kontribute për sigurim shëndetësor në vlerë prej 447 denarë, ndërsa shërbimet që i shfrytëzon brenda një muaji kapin vlerën prej 1953 denarë. Për një të papunësuar - shteti paguan 881, ndërsa shfrytëzohen 1492 denarë**

harxhohen për blerje të ilaçeve të ndryshme nga personat e siguruar", thotë Parnarxhieve-Zmejtkova.

Edhe analisti ekonomik Ivan Vëçkov nga Finance Think thotë se, edhe pse për 10 vite përqindja mujore e kontributeve për sigurim shëndetësor është rritur për 38 për qind, analiza e studimit "Shëndetësia midis presioneve fiskale për investime më të mëdha dhe nevoja për shëndet më të mirë të qytetarëve" tregon se pjesa më e madhe e parave të parapara me Buxhet, Ministria e Shëndetësisë i harxhon për financimin e dy programeve kryesore, investime kapitale: mbrojtje shëndetësore preventive dhe mbrojtje shëndetësore kurative. "Një bujk mesatarisht për kontribute shëndetësore në muaj paguan më pak, ndërsa shfrytëzon më shumë shërbime shëndetësore. Në anën tjetër, një i punësuar paguan më shumë kontribute për sigurim shëndetësor ndërsa shfrytëzon më pak shërbime shëndetësore. Një bujk brenda një muaji paguan kontribute për sigurim shëndetësor në vlerë prej 447 denarë, ndërsa shërbimet që i shfrytëzon brenda një muaji kapin vlerën prej 1953 denarë. Për një të papunësuar - shteti paguan 881, ndërsa shfrytëzohen 1492 denarë. Një pensionist paguan 1788 denarë, ndërsa shfrytëzon shërbime mjekësore në vlerë prej 1993 denarë. Në anën tjetër, një i punësuar kontribute për sigurim shëndetësor paguan 2383 denarë, ndërsa shfrytëzon më pak shërbime mjekësore në vlerë prej 1349 denarë", thotë analisti ekonomik Ivan Vëçkov nga "Finance Think". Ndryshe, studimi në fjalë është mbështetur edhe nga Instituti për hulumtime politike dhe ekonomike "Finance Think".

# Arti i edukimit

Nga Xheladin MURATI



**E**dukata është një treguese e sigurt e gjendjes qytetëruese të një populli, të një shoqërie. Pavarësisht kufizimeve të saja që ka, arti i të edukuarit e bën të mundshme përmirësimin e asaj që nuk bën. Edukata është zbulimi i mendjes dhe shpirtit. Nëpërmes saj vijjnë përsosja, qetësia, dija dhe virtuti, elemente më të rëndësishme të njeriut. Arti edukimit është art i punës dhe mësuesit e njohin artin e punës. Po qe se kjo i mungon mësuesit atij nuk i mbetet asgjë. Gjithmonë mësuesi mundohet ta gjejë një mundësi për realizimin e punës edukative-arsimore dhe ajo punë të jetë unike si nga ideja ashtu edhe nga metoda, forma dhe teknika. Këtu qëndron arti i edukimit.

## CILI ËSHTË QËLLIMI I ARTIT TË EDUKIMIT?

Kur flasim për edukatën, zakonisht mendojmë për aspektet teorike të saj. Ndërsa kur flasim për edukimin mendojmë procesin praktik, shohim se si zhvillohet dhe sundohet nxënësi. Pushtimi apo promovimi i saj bëhet nga edukatori, mësuesi. Nëpërmes artit të edukimit nxënësit e shijojnë madhësinë e saj. "Arti i edukatës, që ushtron mësuesi, është më i larti e më fisniku i arteve, nuk kanë thënë kot ars atriium education" - thotë Aleksandër Xhuvani, pedagog i njohur shqiptar. Arti i edukimit reflekton gjithanshëm pozitivisht dhe me efikasitet në zhvillimin e nxënësit. Reduktohet depressioni dhe stresi, rritet cilësia e zhvillimit. Arti i edukimit forcon trupin dhe intelektin, si dhe ofron shumë përfitime tjera shpirtërore, morale-etike, estetike, sociale-emocionale e të ngjashme. Pra arti i edukimit ndihmon fuqinë intelektuale, vështrimin e brendshëm të nxënësit, ndërton kritikizmin ndaj ngjarjeve dhe sjelljeve jo të përshtatshme me rrethin. Prandaj edukata duhet të ripërkufizohet gjithnjë. Dy parimet bazë të arsimit, edukatorit për edukim në procesin e edukimit janë: parimi njerëzor dhe parimi i patriotizmit. Mendoj që të jesh arsimtar, edukator duhet t'i kesh të dyjat, njëra pa tjetrën nuk bëjnë dhe nuk e kompletojnë edukatorin. Edukimi fillon me takimin e të dyjave. Në këtë kontekst, edukimi do të duhej të reflektonte sa më shumë realitetin jetësor, do të duhej të jetë një pasqyrë e problemeve shoqërore që e preokupojnë jetën, në qendër të së cilës është njeriu modern i kohës tonë. Ai është nxënësi si protagonist

i së nesërme, dhe atë duhet ta karakterizon elementi njerëzor dhe patriotik. Në fakt, ka shumë arsye përse mësuesia, edukimi renditet tashmë si një nga profesionet më të rëndësishme, së pari sepse pas kësaj qëndron një vullnet i fortë dhe dëshirë e madhe për të bërë gjëra të mira dhe ndryshe, siç është arti i edukimit. Gjithashtu investimi në formimin e individit dhe efektet nga ajo e bëjnë diferencën e qëllimit. Mësuesit duhet të bëhen të pushtetshëm si arkitekt të programit mësimor dhe procesit të edukimit. Kjo edhe për arsye se edukata prekën zemrën, thelbin dhe rëndësinë e vërtetë të njeriut. Prandaj edukatën duhet ta kthejmë në shkollë. Në fakt mësuesi, edukatori janë arkitekt të vërtetë me mundësi të gjera shprehjeje për të ndikuar tek individi. Edukata nuk hahet, por na bën më të mirë, më të vetëdijshëm, na pasuron shpirtin, prandaj duhet të merremi me të jo formalisht por esencialisht. Edukimi është kod etikë i sjelljes mbase ai flet se si duhet të sjellemi me njëri tjetrin në familje, në shkollë, në rrugë e gjetiu si në jetën personale ashtu edhe në ate profesionale. Kryesisht kodi etikë i edukimit mbështetet në ndershmëri, drejtësi, guxim,

dashamirësi, mirësjellje, besnikëri, sinqeritet, vetëkontroll e të ngjashme. Faktikisht mirësjellja i ka rrënjët në edukatë të mirë dhe respekt. Prandaj nuk duhet të pushojmë së foluri rreth edukatës sepse ajo është arma për ti bërë ballë jetës sonë. Pra nuk ka art më të lartë se arti i edukimit. Virtutet dhe vlerat morale, bujaria dhe kultura e rafinuar qytetare, kujara dhe sensi për ndryshime pozitive, përshtatje me ndryshimet, janë elementet që e bëjnë njeriun, nxënësin të përballet me problemet dinamike të jetës. Pikërisht këtu duket arti i edukimit, artikulli i interesave personale me ato shoqërore, aspektet njerëzore dhe humane që kanë të bëjnë me ngritjen e ndërgjegjes dhe vetëdijes morale, kombëtare, shoqërore. Me përgjegjësi themi se edukata nuk guxon të harrohet, të lihet mënjanë sepse njeriu mund të shkatërrohet çdo ditë nga pak. Ai duhet t'i mbijetojë kohës duke e përsosur veten me edukim.

## CILA ËSHTË KORNIZA PEDAGOGJIKE SA I PËRKET REALIZIMIT TË ARTIT TË EDUKIMIT?

Një prej sfidave me të cilat përballen mësuesit, edukatorët si aktor

**Mësuesit duhet të bëhen të pushtetshëm si arkitekt të programit mësimor dhe procesit të edukimit. Kjo edhe për arsye se edukata prekën zemrën, thelbin dhe rëndësinë e vërtetë të njeriut. Prandaj edukatën duhet ta kthejmë në shkollë**



të edukimit është fakti që megjithatë edukimi është art kolektiv dhe puna e mësuesit varet jo vetëm nga ai por edhe nga një numër i madh faktorësh të tjerë, subjektiv dhe objektiv. Për ta objektivizuar artin e edukimit, qasjet didaktike janë të domosdoshme. Për të qenë pjesë e inxhineringut edukativ është me rëndësi të përdoren, metoda, teknika, mjete, plane e programe, metodologji, stil pune, modele edukimi, dizajnim i përmbytjeve, parashtrim i objektivave, menaxhim të procesit. Mendoj se serioziteti i detyrës së edukimit kërkon që të shqyrtohen mirë hapat që ndërmerren në edukim, për shkak se edukimi nuk do sjellë zgjidhje të problemeve, ashtu siç ndodh edhe sot. Arti i edukimit ndihmon me forcën e tij në cilësinë e procesit edukativ, në selektim të normave dhe vlerave personale e shoqërore dhe formimit të personalitetit. Në këtë kontekst gjykoj se edukata mbartë me vete mite dhe histori të jashtëzakonshme. Shpejtësia e kohës sonë na nxit që edhe dizajnimin e punës edukative të rregullojmë në mënyrë të tillë që ajo të reflektojë suksesshëm në ngritjen e individit. Ky është arti i edukimit, ku edukatori ndjek ndryshime në formimin e nxënësit qof-

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 4 janar | Numri i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 221 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

shin të mëdha apo të vogla ato. Arti i edukimit kërkon punë me përkushtim, bindje dhe përgjegjësi. Përgjegjësia është shumë e rëndësishme tek çdo profesion, por tek mësuesia ajo vjen në shprehje shumë për dy arsye: prej faktit se një mësues ka përgjegjësi se e projekton ardhmërinë e nxënësit, e dyta, sepse lënë gjurmë në shoqëri për shumë breza. Duke u bazuar në teoritë e përgjithshme të edukatës, ajo që vëmë re fillimisht tek procesi i edukimit është arti i të realizuarit të edukimit, finesat e edukimi, stili i edukimit, pasioni dhe përkushtimi. Arti i edukimit karakterizohet me një arkitekturë të mirëfilltë metodike e cila mundëson infrastrukturën e formimit të njeriut dhe ndërton trasenë e qëllimeve zhvillimore. Thjesht edukimi kërkon mençuri dhe talent.

#### ÇFARË MUND TË BËHET MË SHUMË NË KËTË DREJTIM?

Mësuesi bëhet pjesë e ndryshimeve shoqërore e perceptimeve individuale nëpërmes punës edukative. Edukimi është dashuri, është respekt, është art të cilin mësuesi mundohet ta sendërtojë në punën praktike. Nga kjo që theksuam më lartë vlen të theksoj se: 1) Arti i edukimit varet rëndësisht nga arsimitari dhe nga ritmi i jetës dhe nga ndryshimet në shoqëri të cilat reflektojnë shumanshëm në edukim. 2) Psikologjikisht arti i edukimit realizohet ngjashëm si leximi në heshtje i cili përfshin mësuesin dhe nxënësin. Por ky ndikim reflektues nuk mund të vihet nën kontroll personal. 3) Arti i edukimit nënkupton përtyppjen e fjalëve pa i thënë ato me zë të lartë, por me besim, mbase kuptimi i tyre për të ndërtuar një botë më vete në kokën e nxënësit është reflektues. Dhe për këto arsye, arti i edukimit për mua mbetet treguesi më i mirë i punës së mësuesit, ngase është një paraqitje sfiduese profesionale dhe nuk është çështje kalimtare por esenciale. Rruga e artit të edukimit si koncept asnjëherë nuk duhet të qëndrojë në vend, arti i vërtet i edukimit është gjithmonë në lëvizje, në kërkim të rrugëve të reja për modernizimin e mësimdhënies. Mbi bazë të kësaj që parashtruam del konkludimi: (1) Arti i edukimit është pikërisht mënyra për të përmirësuar apo pikturuar sundimin e metodologjisë, dhe për të shuar investimet didaktike-metodike në procesin e mësimdhënies dhe njohjes mësimore. (2) Avanci i artit të edukimit, është një ndër shtyllat kryesore për të cilat mësuesi angazhohet, dhe një fokus i tillë rezultojnë me sukses dhe efikasitet. (3) Arti i edukimit mbetet sfidë institucionale dhe personale e çdo mësuesi.

# Pesë arsye për t'u shqetësuar për Iranin



Nga Bernard GUETTA

**M**ë 1 janar 2018, një polic u vra në Iran. Kjo ndodhi në Najafabad, në qendër të vendit.

Disa qytete të tjera kanë qenë skena të protestave të reja dhe në disa raste, janë sulmuar stacionet policore dhe kazermat. Irani ka përjetuar protestat e radhës në rrugë, kundër shtrenjtimit të jetesës, papunësisë, korrupsionit të njerëzve me pushtet, dhe - risi absolute kjo - kundër institucioneve dhe mullahëve. Të vdekurit janë të shumtë. Megjithëse numri i protestuesve është ende mjaft i kufizuar (sidomos në kryeqytet, Teheran), nuk është e qartë nëse Republika Islamike po zhytet në një krizë shkatërruese. Kjo do të kuptohet këto ditë. Ndërkohë, mund të pikasim pesë arsye për t'u shqetësuar. Por, çfarë duan iranianët?

E para është se iranianët nuk shohin që kushtet e tyre të jetesës të jenë përmirësuar, pavarësisht se sanksionet ndërkombëtare janë anuluar falë marrëveshjes bërthamë

**Konservatorët nuk e kanë thënë ende fjalën e tyre të fundit. Pavarësisht si do të zhvillohet situata në ditët e ardhshme, është e qartë se në Iran ekziston një jetë politike gjithmonë e më komplekse, dhe gjithnjë e më pak e aftë për të kanalizuar refuzimin e një teokracie, tashmë të përçmuar dhe të rrethuar**

more të firmosur me fuqitë e mëdha, nga presidenti Hassan Rohani.

E dyta është se vazhdimi i normës së lartë të papunësisë dhe inflacionit e bën përhapjen kapilare të korrupsionit tashmë të padurueshme.

E treta është se kjo pakënaqësi sociale i shtohet një dëshirë për liri, që është përhapur në të gjithë vendin, që nga vitet '90.

E katërta është që iranianët do të preferonin që paratë nga shitja e burimeve natyrore të investoheshin për të përmirësuar standardin e tyre të jetesës, dhe jo për të mbështetur regjimin sirian dhe Hezbollahun në Liban.

Arsyeja e pestë e kësaj krize potenciale është se pushteti iranian është thellësisht i ndarë midis pragmatistëve dhe reformatorëve, që mbështesin presidentin Rohani dhe rrymat e ndryshme konservatore, që frikësohen nga humbja e privilegjeve të tyre ekonomike. Midis këtyre dy palëve

beteja po përkeqësohet, edhe nga fakti se udhëheqësi suprem është i sëmurë dhe lufta për pasardhësin pothuaj është hapur.

Vendi jeton një luftë me llogore, ku konservatorët kanë menduar që të përfitojnë prej protestave të para për të vënë në vështirësi Rohanin. Në 30 dhjetor 2017, u bë e qartë se në këtë mënyrë kishin hapur kutinë e Pandorës, dhe Rohani u përgjigj duke propozuar t'u japë më shumë liri atyre që kritikojnë politikanët dhe duke shfaqur vendosmëri të lartë përballë akteve të dhunës. Konservatorët nuk e kanë thënë ende fjalën e tyre të fundit. Pavarësisht si do të zhvillohet situata në ditët e ardhshme, është e qartë se në Iran ekziston një jetë politike gjithmonë e më komplekse, dhe gjithnjë e më pak e aftë për të kanalizuar refuzimin e një teokracie, tashmë të përçmuar dhe të rrethuar. (*Rance Inter*)

Vendi jeton një luftë me llogore, ku konservatorët kanë menduar që të përfitojnë prej protestave të para për të vënë në vështirësi Rohanin. Në 30 dhjetor 2017, u bë e qartë se në këtë mënyrë kishin hapur kutinë e Pandorës, dhe Rohani u përgjigj duke propozuar t'u japë më shumë liri atyre që kritikojnë politikanët dhe duke shfaqur vendosmëri të lartë përballë akteve të dhunës.





# MBI 350 MIJË ARMË

## ILEGALE NË DUART E QYTETARËVE

Gjatë vitit 2017, janë konfiskuar rreth 1500 armë ilegale dhe numër i madh i municionit nga duart e qytetarëve. Por, njohës të çështjes së sigurisë thonë se janë rreth 350 mijë armë të vogla e të lehta, që qytetarët i posedojnë në mënyrë ilegale

Një persona nga Komuna e Sh-times, ishte raportuar nga Policia e Kosovës, të ketë qenë viktimë e radhës e plagosjes nga një plumb qorr, si pasojë e festimeve me të shtëna armësh, gjatë natës së Vitit të Ri. Raste të tilla në Kosovë përsëriten qoftë gjatë festave, apo ahengjeve familjare, ngaqë festimet me të shtëna armësh, tashmë janë bërë një lloj tradite në Kosovë, ndonëse një mënyrë e tillë festimi është e ndaluar me anë të ligjit. Përdorimi i armëve gjatë festimeve, bëhet edhe më i rrezikshëm për faktin se statistikat tregojnë për një numër të madh të armëve ilegale që vazhdojnë të mbeten në duart e qytetarëve. Gjatë vitit 2017, janë konfiskuar rreth 1500 armë ilegale dhe numër i madh i municionit nga duart e qytetarëve. Por, njohës të çështjes së sigurisë thonë se janë rreth 350 mijë armë të vo-

gla e të lehta, që qytetarët i posedojnë në mënyrë ilegale. Numri i madh i armëve ilegale në duart e qytetarëve, paraqesin rrezik për sigurinë e përgjithshme në Kosovë dhe në veçanti për vetë qytetarët.

Kështu thonë njohës të çështjes së sigurisë, sipas të cilëve armët ilegale janë një prej problemeve kryesore që e ka aspekti i sigurisë publike në Kosovë. Eksperti për çështje të sigurisë nga Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë, Burim Ramadani, thotë për Radion Evropa e Lirë se posaçërisht përdorimi i armëve nga të miturit mbetet mjaft shqetësuese për sigurinë në vend. "Nga raporti i UNDP-së llogaritet që janë 350 mijë armë të vogla dhe të lehta në formë ilegale në duart e qytetarëve. Policia disa herë ka shkatërruar një numër të tyre, prezencë mbetet jashtëzakonisht e madhe". "Janë

dy mënyra të ndryshme për ta larguar këtë dukuri negative. E para është rritja e vetëdijesimit sidomos tek prindërit, që të mësojnë fëmijët e tyre për pasojat e armëve ilegale, si dhe të ndërtohet një program nacional kombëtar për të shkëmbyer armët ilegale me elemente tjera, që mund t'i hyjnë në punë familjeve", tha Ramadani.

Autoritetet e rendit ndërkaq kanë theksuar faktin se janë lansuar në vazhdimësi fushata vetëdijësuese për rrezikun që paraqesin armët ilegale dhe posedimi apo përdorimi i kundërligjshëm i tyre. Daut Hoxha, zyrtar për informim në Policinë e Kosovës, tha se mesatarisht çdo vit nga Policia, përmes operacioneve aktive policore, konfiskohen rreth 1200 deri 1500 armë të llojeve të ndryshme. "Policia e Kosovës bazuar në detyrat dhe autorizimet ligjore, në vazhdimësi ka

ndërmarrë veprime konkrete në funksion të krijimit të një sigurie më të madhe për qytetarët, duke konfiskuar edhe një sasi të konsiderueshme të armëve, mjeteve të pashpërthyer dhe municioneve të ndryshme gjatë gjithë këtyre viteve të pasluftës", tha Hoxha. "Inkurajojmë të gjithë ata që kanë informacione relevante të cilat mund të çojnë në identifikimin apo gjetjen e armëve, municioneve apo mjeteve tjera të rrezikshme, që cenojnë sigurinë e qytetarëve, të njoftojnë Policinë, të bashkëpunojnë me organet kompetente, dhe veprime të nevojshme do të ndërmerren sipas ligjeve në fuqi", tha Hoxha. Ndryshe, posedimi i armëve në Republikën e Kosovës rregullohet me ligj, prandaj edhe bartja apo posedimi i tyre në mënyrë të kundërligjshme është e sanksionuar me ligj.



### "Vetë do ta zgjidhin problemin me Slloveninë dhe Serbinë"

Për shkak të përshkallëzimit të kontestit territorial në Gijirin e Piranit, veterani kroat i luftës Petar Janjiq i quajtur Tromblon, ia ka dërguar një letër "kërcënuese" kryeministrit të Kroacisë, Andreja Plenković, në të cilën i ka dhënë afat që kontestin me Lubjanën ta zgjidhë brenda 72 orëve, ose në të kundërtën, ka shkruar ai, veteranët vetë do zgjidhin problemin. Letra e Janjiqit është publikuar në disa portale djathtiste kroate, përcjell Al Jazeera. Janjiq është kërcënuar se nëse Plenković në afatin prej 72 orësh nuk e zgjidh problemin me Slloveninë, do t'i organizojë 100 anije peshkatarësh e veteranësh të luftës të cilët "do ta mbrojnë kufirin detar me Slloveninë nga hyrja ilegale e policisë së huaj në ujërat territoriale kroate". Në letrën ultimatum theksohet se nëse kryeministri nuk i përmbush kërkesat e tij, "ai do t'i sigurojë peshkimin e pa-penguar për peshkatarin kroat nga Istra në mënyrë që të peshkojë i lirë e ta ushqejë familjen e vet". Janjiq ka thënë gjithashtu se "24 mijë hektarë tokë kroate i ka marrë Serbia dhe ka shtuar se organizata, pjesë e të cilës është, nuk do të rrijë duarkryq ndaj këtij problemi". "Gjatë 26 vjetëve të shkuar, jemi dëshmitarë të mjerrimit të politikës sonë të jashtme në zgjidhjen e shumë çështjeve kryesore për të ardhmen e Kroacisë. Krahas kësaj, pos me Hungarinë, me asnjë shtet fqinj nuk është zgjidhur asnjë problem serioz. Ende s'e kemi zgjidhur çështjen e kufirit shtetëror me Serbinë e fjala është për 24 mijë hektarë tokë kroate në Serbi", citon index hr. të ketë thënë Janjiq. Kroacia dhe Serbia kanë mospajtime rreth përcaktimit të kufirit sidomos përgjatë lumit Danub.

## HARADINAJ SHKELI LIGJIN PËR GRUPIN E KUMANOVËS

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GSPJ), Instituti GAP dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) mbajtën konferencë për media ku u prezantua analiza e politikave e titulluar "Vlerësimi i 100 ditëve të para të Qeverisë Haradinaj". Nora Latifi-Jashari nga Instituti GAP tha se gjatë 100 ditëshit të parë, Qeveria Haradinaj ka shtuar 2 ministri të reja dhe ka dyfishuar numrin e zëvendësministrave. Pasi Qeveria Haradinaj përbëhet nga 23 parti dhe një anë-

tar i pavarur duke bërë kështu që ajo të llogaritet në mesin e qeverive më të mëdha në Evropë. Delfinë Elshani nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike tha se gjatë 100 ditëshit, Qeveria Haradinaj ka zhvilluar 19 takime në të cilat janë marrë 202 vendime e janë ndarë 3,6 milionë euro nga buxheti për shpenzime të paparashikuara. Elshani ka thënë se një prej veprimeve të gabuara që ka bërë Qeveria me në krye Ramush Haradinaj është edhe kompensimi i personave të

vdekur ose të dënuar nga Gjykatat maqedonase të cilët ishin të përfshirë në rastin e Kumanovës. "Kompensimi i këtyre individëve që marrin pjesë në një konflikt jashtë vendit është i pamatur dhe shkel Ligjin aktual për Ndalimin e Pjesëmarrjes në Konflikte të Armatosura jashtë vendit. Prioritet e kryeministrit nuk kanë përkuar me premtimet zgjedhore", ka thënë Elshani. Sipas tij, Qeveria më shumë vepron sipas impulseve sesa me një plan strategjik.



# KARATE NË VEND TË XHIHADIT

Kickboks apo karate kundër urrejtjes dhe fanatizmit - tingëllon si paradoks, por nuk është i tillë - të paktën sipas OJQ-së austriake "Not in God's Name"

Anëtarët e nismës "Not in God's Name" (Jo në emër të Zotit) janë sportistë të njohur, shumica e tyre myslimanë dhe duan të jenë shembull për të rinjtë. Ata i nisën aktivitetet e tyre pak kohë pas sulmeve ndaj redaksisë së Charlie Hebdo në fillim të vitit 2015. "Sportet luftarake për fëmijët i bëjnë ata të mësohen të mos dorëzohen në jetë, të bëhen këmbëngulës. Pra që gjithmonë kur të kenë një qëllim ta realizojnë atë", thotë kikkoksieri Karim Mabrouk, një nga themeluesit e OJQ-së. Kush ka një perspektivë dhe ka me se të merret, p.sh. me stërvitje, nuk ka kohë të dëgjojë ekstremistët, mendon ai. 24-vjeçari Karim është shpallur disa herë kampion i Austrisë në kikkoks dhe ka zhvilluar ndeshje në mbarë



Evropën. Islamistët preferojnë të rekrutojnë pasardhës nga radhët e të rinjve që merren me sporte luftarake. Pikërisht këtu është fokusuar edhe nisma "Not in God's Name". Ata kanë postuar edhe video në internet. Ndër të tjera në video thuhet: "Në ring ti duhet të japësh gjithçka, të jesh agresiv. Por më pas, ne jemi si vëllezër, pavarësisht, nëse përballë meje ndodhet një hebre, një i krishterë apo një mysliman. Ne e respektojmë njeri-tjetrin jashtë ringut. Nëse predikuesi do të ta

mbushë mendjen, se nuk mund të arrish asgjë këtu në Austri, atëherë duhet ta dish, se këtu ka një komunitet. Ti ke vendin tënd këtu". Anëtarët e nismës "Not in God's Name" shkojnë dhe zhvillojnë takime edhe me nxënësit në shkolla. Aty ata diskutojnë për sulmet terroriste islamiste. "Asnjë mysliman nuk duhet të bëjë sulme të tilla, pavarësisht nga prejardhja. Asnjë i pafajshëm nuk duhet vrarë", u thotë kikkoksieri Karim Mabrouk nxënësve. "Unë përpiqem të kontribuoj me

më të mirën duke dhënë shembullin pozitiv për një mysliman", thotë Karimin që është me origjinë nga Egjipti. Për të besimi është shumë i rëndësishëm dhe si mysliman që praktikon fenë ai lutet pesë herë në ditë. Por ndonëse ai vetë ka lindur në Vjenë, ai vëren se po bëhet e vështirë të jetosh si mysliman në Austri. "Qëkurse isha i vogël e ndjeja se më ngacmonin apo më shihnin shtrëmbër për faktin se isha mysliman. Tani kam frikë se mund të bëhet edhe më keq", thotë Karimi.

## Irani ankohet në OKB, akuzon SHBA-të për ndërhyrje në punët e brendshme

Irani është ankuar në Komitet e Bashkuara (OKB) kundër SHBA-së të cilën e fajëson për përfshirjen e saj në çështjet e brendshme lidhur me protestat e vazhdueshme në vend. Përfaqësuesi i Përhershëm i Iranit në OKB, Gholamali Khoshroo në një letër dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Antonio Guterres dhe Këshillit të Sigurimit të OKB-së ka thënë: "Qeveria e SHBA-së ka rritur në mënyrë të pakuptueshme veprimet e ndërhyrjes në punët e brendshme të Iranit me pretekstin e mbështetjes së demonstratave. Presidenti amerikan Donald Trump dhe Zv/presidenti Mike Pence kanë inkurajuar iranianët me veprime provokuese me postime të shumta pa kuptim në Twitter". Duke akuzuar SHBA-të për shkeljen e të drejtës ndërkombëtare dhe parimeve të Konventës së OKB-së, Khoshroo ka bërë thirrje që të dënohen deklaratat e administratës së Trump-it lidhur me Iranin. Ndërkohë Trump në lidhje me zhvillimet në Iran kishte thënë se, "Unë respektoj popullin e Iranit që po përpiqet të rimarrë qeverinë e tyre të korruptuar. Kur të vijë koha, do të merrni mbështetje të madhe nga SHBA-të". Protestat në Iran filluan më 28 dhjetor 2017, pasi një grup demonstruesish u mblodhën në qytetin Meshhed për të protestuar kundër kostos së lartë të jetesës, papunësisë dhe korrupsionit në vend.

## Izraeli miratoi "dënimin me vdekje" për palestinezët

Projektligji që parasheh dënimin me vdekje për palestinezët është miratuar në leximin e parë të mbajtur në Parlamentin e Izraelit (Knesset), transmeton Anadolu Agency (AA). Sipas njoftimit të publikuar në faqen zyrtare të Knesset, në votimin e parë projektligji në fjalë ka marrë 52 vota "pro", ndërsa 49 "kundër". Kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, duke e mbrojtur projektligjin për dënim me vdekje, tha se ky dënim nënkupton "drejtësi në raste ekstreme". Ai duke rikujtuar sulmin të bërë në korrik të vi-



tit të kaluar kundrejt vendbanimit të paligjshëm Neve Tsuf në Bregun Perëndimor, tha: "Në jetën time kam parë shumë gjëra

shokuese, por përsëri ky incident më shokoi. Ka shembuj ku njerëzit kryejnë krime të tmerrshme dhe nuk meritojnë të jetojnë.

Ligjin e ndërrojme për këto gjendje". Ndërsa, Avigdor Lieberman, ministri i Mbrojtjes dhe lideri i partisë Izraeli Shtëpia Jonë, që është një ndër partnerët e koalicionit, në një deklaratë të mëparshme i dha mbështetje projektligjit duke thënë se "Gjaku i izraelitëve nuk është i lirë". Projektligji që të hyjë në fuqi duhet të miratohet edhe dy herë nga parlamenti. Në gjykatat civile të Izraelit nuk gjendet dënim me vdekje. Ndërsa në gjykatat ushtarake ky dënim mund të jepet në gjendje të jashtëzakonshme.

## FËMIJËT SIRIANË MBJELLIN TË ARDHMEN

"Në kuadër të kësaj fushate ne synojmë që t'u japim fëmijëve vetëbesim. Duam që fëmijëve t'u rrisim ndjenjën e përgjegjësisë sociale", tha Sadettin

Fëmijët e qarqeve të qytetit Humus në Siri, të cilat ndodhen nën rrethimin e regjimit të Bashar al Asadit, po mbjellin fidanë në vend të pemëve të cilat janë djegur për ngrohje. Veriu i qytetit të Humusit gjatë pesë viteve është nën rrethimin e regjimit në Siri, ku për afro shtatë vite po vazh-

don lufta e brendshme. Në këtë rajon ku jetojnë 250 mijë civilë, familjet janë detyruar që t'i prejnë pemët për t'u ngrohur meqë në rajon nuk mund të futen karburantet dhe regjimi nuk ofron energji elektrike. Organizatat civile në vend janë duke zhvilluar aktivitete për mbjelljen e fi-

danëve për të gjelbëruar rajonin si dhe për të dhënë shpresë për fëmijët, viktimat e luftës. Në kuadër të aktivitetit të quajtur "Po e mbjellim të ardhmen", i cili po mbahet në intervale të caktuara kohore, fëmijët mbjellin dhjetëra fidane në skaje të rrugës dhe në parqe, duke shëtitur me autobus



qarqet dhe qytezat e Humusit të cilat janë nën rrethim. Organizatori i fushatës, kryetari i Shoqatës për Ndhimë dhe Zhvillim "Ihsan",

Hani Sadettin tha se synojnë që së bashku me fëmijët të mbjellin të paktën 300 fidanë në zonën rurale veriore të Humusit.

DOKUMENTE EKSKLUZIVE

# KËRKESA E PPD-së DHE REAGIMI I QEVERISË SË RSM-së



Nga Qerim LITA

Politika represive ndaj popullsisë shqiptare që udhëheqja politike e ekzekutive maqedonase e zbatonte gjatë muajve mars-prill 1991, në radhë të parë kundër arsimtarëve shqiptar, të cilët me përkrahjen e madhe që e morrën nga prindërit, dokumentacionin dhe evidencën pedagogjike e udhëhiqnin në gjuhën shqipe, si dhe kundër disa personaliteteve shqiptare me ndikim, me arsyetim se "e penguan" mbajtjen e regjistrimit të popullsisë. Këshilli Drejtues i Partisë për Prosperitet Demokratik, në mbledhjen e mbajtur më 3 maj 1991, përmes një kërkesë iu drejtua institucioneve më të larta politike e ekzekutive të RSM-së, në të cilën ndër të tjerave u kërkuar ndërprerja e menjëhershme e masave represive kundër shqiptarëve, si dhe ndryshimi i menjëhershëm i dy ligjeve diskriminuese për shqiptarët: Ligji për edukimin dhe arsimimin parashkollor e fillor dhe Ligji për arsimin e mesëm të orientuar. Kërkesa prej dy faqesh kishte këtë përmbajtje:

**"KRYETARIT TË REPUBLIKËS KRYETARIT TË KUVENDIT TË RSM-SË KRYETARIT TË QEVERISË SË RSM-SË MINISTRISË SË ARSIMIT LËNDA: KËRKESË**

Këshilli Drejtues i Partisë për Prosperitet Demokratik në mbledhjen e mbajtur më 3 maj të vitit 1991 e shqyrtoi situatën e krijuar në lidhje me paditë për kundërvajtje kundër arsimtarëve shqiptar për shkak udhëheqjes në gjuhën shqipe të dokumentacionit e të evidencës pedagogjike, si dhe të qytetarëve shqiptar për shkak mospjesëmarrjes në regjistrimin e popullsisë vendosi që institucioneve të lartshënuara t'u dorëzoj kërkesë me përmbajtje me sa vijon:

Këshilli Drejtues i PPD-së vlerëson se dispozitat e ligjeve për arsimin fillor e të mesëm të cilat i përkasin mënyrës së udhëheqjes së dokumentacionit e të evidencës pedagogjike vetëm në gjuhën ma-

Organet e pushtetit të Maqedonisë shumë nacionale në vend se të gjejnë zgjidhje minimale civilizuese e demokratike të cilat të çojnë kah barazia e bashkëjetesa - ofrojnë dhe zbatojnë represion masiv mbi arsimtarët pjesëtar të kombit shqiptar me ngritjen e padive penale e për kundërvajtje kundër tyre vetëm për shkak asaj se ashtu sikurse kolegët e tyre maqedonas evidencën pedagogjike e udhëheqin në gjuhën me të cilën zhvillohet mësimi....




qedonase, janë në kundërshtim me Konventat ndërkombëtare për përdorimin e gjuhës e të shkrimit dhe vendimeve kushtetuese të Jugosllavisë e Maqedonisë, përkatësisht në kundërshtim me nenet 170 e 171 të Kushtetutës së RSFJ-së dhe neneve 179, 180 dhe 181 ndërsa në kuptimin e nenit 3 nga Kushtetuta e RSM-së në shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën mësimore shqipe përkatësisht gjuhës mësimore turke mohohet e drejta e udhëheqjes së dokumentacionit e të evidencës pedagogjike në gjuhën në të cilin zhvillohet mësimi. Duke i shfrytëzuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, shkollat përkatësisht arsimtarët shqiptarë me pajtuashmëri të plotë të prindërve evidencën pedagogjike e udhëheqin në gjuhën shqipe.

Organet e pushtetit të Maqedonisë shumë nacionale në vend se të gjejnë zgjidhje minimale civilizuese e demokratike të cilat të çojnë kah barazia e bashkëjetesa - ofrojnë dhe zbatojnë represion masiv mbi arsimtarët pjesëtar të kombit shqiptar me ngritjen e padive penale e për kundërvajtje kundër tyre vetëm për shkak asaj se ashtu sikurse kolegët e tyre maqedonas evidencën pedagogjike e udhëheqin në gjuhën me të cilën zhvillohet mësimi.

Organet e pushtetit për "vendosjen" e "rendit e qetësisë" e të "ligjshmërisë" u vërsulën me metoda të dhunshme duke ngritur padi për kundërvajtje kundër qindra arsimtarëve.

Këshilli Drejtues i PPD-së konsideron se në këtë mënyrë dhe me metoda të këtylla Maqedonia është gjithnjë e më afër Kosovës, Kninit, Pakracit, Plitvicës, Vukovarit e vendeve tjera në të cilat marrëdhëniet ndërnacionale janë të ngjashme me këto në Maqedoni.

Duke e analizuar pozitën e



shqiptarëve në Maqedoni, veçmas në fushën e arsimit Këshilli Drejtues konstatoi se shqiptarët në Maqedoni janë në pozitë më të keqe krahasuar me pozitën e shqiptarëve në Kosovë, Mal të Zi dhe Serbinë Jugore ku në shkollat në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe evidenca pedagogjike udhëhiqet në gjuhën e njëjtë e në të cilën gjuhë shqiptarët shkollohen edhe në shkollimin e mesëm.

Për sa u tha më sipër Këshilli Drejtues, në interes të barazisë, bashkëjetesës dhe marrëdhënieve ndërnacionale të mira, institucioneve më lart u propozon sipas të drejtave, obligimeve e kompetencave të veta të iniciojnë e të ndërmarrin masa urgjente për ndryshimin e Ligjit për edukimin e arsimimin parashkollor e fillor dhe Ligjin për arsimin e orientuar në kuptimin e sigurimit e të drejtës kushtetuese për shkollim në gjuhën amtare të mbarë qytetarëve në Maqedoni pa marrë parasysh përkatësinë nacionale dhe dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike të udhëhiqet në gjuhën në të cilën zhvillohet mësimi.

Institucionet e lartpërmendura të ndërmarrin masa për tërheqjen dhe ndërprerjen e procedurës së padive penale e për kundërvajtje kundër arsimtarëve në shkollat në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe ndërsa evidenca pedagogjike udhëhiqet në atë gjuhë. Kjo aq më tepër se në kontaktet e deritani-shme me organet kompetente shtetërore, represioni si metodë për zgjidhjen e çështjeve të hapura në mënyrë më të hapur që dënuar nga ana e vet organeve kompetente.

Këshilli Drejtues i PPD-së konsideron të gjitha mosmarrëveshjet e hapura nga fusha e marrëdhënieve ndërnacionale mund të tejkalohen me metoda demokratike e civilizuese ndërsa represioni paraqet vetëm një hap më larg bashkëjetesës.

*Partia për Prosperitet Demokratik Këshilli Drejtues*

Kërkesa e Këshillit Drejtues të PPD-së u shqyrta në mbledhjen e Kuvendit të RSM-së të mbajtur më 24 qershor 1991, me çrast, grupi parlamentar shqiptar, përkatësisht, koalicionit PPD-PDP-ë, mbrojtën denjësisht kërkesën e partisë më të madhe shqiptare, e cila njëheri paraqiste kërkesë e mbarë popullit shqiptar në RS të Maqedonisë. Ndërkohë, Qeveria e RSM-së, në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor të atij viti, doli me një komunikatë, përmes së cilës në mënyrë hapur e dënon "sjelljen" e grupit parlamentar të PPD-PDP-së. Se çfarë në të vërtetë thuhej në atë komunikatë, të njëjtën në vazhdim po e publikojmë të plotë:

"Qeveria e Maqedonisë, e motivuar nga parimet për pohimet e pavërteta e të politizuara të grupit parlamentar të PPD-PDP-së në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë të shtruar në mbledhjen e datës 24 qershor 1991, i drejtohet Parlamentit maqedonas (vetë termi "Parlamenti maqedonas" është dëshmia më e fuqishme se në çfarë pozite të palakmueshme e diskriminuese gjendeshin shqiptarët asaj kohe në atë republikë - Q.L.) dhe opinionit publik në Maqedoni me deklaratën si më poshtë:

Qeveria e Republikës së Maqedonisë vlerëson se sjellja e grupit parlamentar të PPD-PDP-së në Kuvendin e Maqedonisë meriton dënim për arsye se përpiqet t'i mjeçgulloj situatat e vërteta në realizimin e të drejtave të pakicës shqiptare në fushën e arsimit e më gjerë. Qeveria, pikërisht vlerëson, çështja minore rreth udhëheqjes së evidencës pedagogjike, shtrihet me qëllim të mjeçgullimit e të drejtave të gjëra të pakicës nacionale që i gëzon në fushën e ar-



simit. Qeveria e Maqedonisë konsideron se megjithatë duhet përkujtuar realizimi dhe aspak i kontestueshëm të mesimit në gjuhën shqipe në shkollimin fillor, për çka Qeveria ofron mbështetje të gjërë dhe jo vetëm politike. Është vështirë të besohet se një Qeveri punon kundër interesave të një pakice vetëm nëse dihet, ndërsa këtë e di çdo kush, se përveç të drejtave dhe barazisë së gjuhës e shkollimit, ekzistojnë dhe me mjete shtetërore ndihmohen: edhe institucione kulturore të pakicës shqiptare, ta përmendim vetëm teatrin e kombësive në të cilin njëri nga dy ansamblet punon në gjuhën shqipe.

Qeveria e Maqedonisë në mënyrë të veçantë thekson se është e palogjikshme të besoj se Qeveria e cila krijon komisione të përziera për zbatimin e regjistrimit të popullsisë, në të cilat në mënyrë obligative përfshihet edhe anëtari shqiptar, punon kundër interesave të pakicës nacionale shqiptare vetëm për shkak problemit të shpikur të fletregjistrimit plotësues në gjuhën shqipe, që ligjërisht është e pamundur. Qeveria i shpreh, përkatësisht i përsërit këto argumente për ta dëshmuar sulmin e paargumentuar ndaj saj i cili vin nga interesat e ngushta partiake.

Sa i përket problemit të evidencës pedagogjike, i cili pa nevojë është politizuar me tendencë të zgjerimit, Qeveria e Maqedonisë nënvizon se nuk pranon dialog nën presion, e as që do të lejoj që t'i parashtrohen ultimatume.

Prandaj, Qeveria e Republikës së Maqedonisë deklaron, se ky si dhe problemet tjera të shumta të cilat shtrihen para nesh, do të përpiqet t'i zgjidh në frymën e vlerave të nënvizuara në Kushtetutë, si dhe në Deklaratën për pavarësimin e Maqedonisë, pranë së cilës do të kujdeset edhe për nevojën që zgjidhjet të përmbajnë edhe nga disa opsione, që të rruhet fryma e zhvillimit të proceseve demokratike, i cili është ringjallur fuqishëm në Republikën e Maqedonisë, për çka janë prezent edhe lëvdatat edhe nga opinioni ndërkombëtar. Lidhur me qëndrimet e këtilla të veta dhe arritjet e përgjithshme në përfundimin e të drejtave të pakicave nacionale në Maqedoni, Qeveria apelon për shkallë më të lartë të besimit e të kuptimit të të gjithë pjesëmarrësit e proceseve të demokracisë parlamentare.

Konsensusi i përgjithshëm është se ai vrau veten me një tabletë cianur, dhe një plumb në kokë në 30 prill të vitit 1945. Megjithatë, sovjetikët nuk kanë qenë aq të sigurt mbi këtë, ndaj ata filluan zbatimin e "Operacionit Miti". Ky qe një hetim mbi vdekjen e Adolf Hitlerit dhe vërtetësinë e trupave që u zbuluan në dalje të bunkerit të nëndheshëm të liderit nazist, kur Ushtria e Kuqe pushtoi Berlinin

Në 30 prill 1945, Ushtria e Kuqe sovjetike ishte duke sulmuar Berlinin. Ndërkohë, Hitleri dhe disa bashkëpunëtorë të besuar, qenë fshehur në bunkerin e nëndheshëm të kancelarisë së Rajhut. Bunkerin qe projektuar posaçërisht për të mbrojtur Fyhrerin. Ai ishte plot me apartamente personale për Adolfin dhe gruan e tij të re (për të cilën publiku nuk kishte dijeni), Eva Braun. Hitleri dhe Eva gjendeshin aty kur supozohet se kryen vetëvrasje, një ngjarje që Operacioni Miti do ta mbulonte gjerësisht. Menjëherë pas vetëvrasjes së supozuar të Adolfit dhe Evës, njerëzit e Hitlerit thuhet se i nxorën trupat e tyre jashtë dhe u përpoqën t'i djegin ato, duke ia dalë pjesërisht. Ata më pas i varrosën trupat në kopshtin e Kancelarisë. Kur mbërriti Ushtria e Kuqe, rusët gjetën një trup që ngjante me Hitlerin. Sovjetikët më vonë do të zbulonin se ai në fakt i përkiste sozisë së Hitlerit, Gustav Veler.

Ata zbuluan më pas edhe dy trupa të djegur pjesërisht. Në fillim, ato u shpërfillën pasi ushtarët besonin trupi i Fyhrerit ishte gjendur më herët. Ata u interesuan për dy trupat, kur i pari rezultoi të qe një mashtrim. Shumë njerëz besojnë se ata i përkisnin Evës dhe Adolfit, edhe pse nuk ka asnjë provë mjeko-ligjore të mbetjeve njerëzore. Sovjetikët pohuan se kishin gjetur trupin e Hitlerit në javët pas pushtimit të Berlinit. Megjithatë, ata e pranuan se kjo nuk ishte e vërtetë. Për të zbuluar nëse Hitleri qe arratisur apo se ku gjendej trupi i tij, nisi Operacioni Miti. Dosja e Operacionit Miti (1-G-23) ka qenë sekrete deri kohët e fundit. Qëkur nga ajo është bërë publike (në një farë masë), ne e dimë se fokusi i operacionit ishte intervistimi i njerëzve që qenë të afërt me Hitlerin, dhe që ndodheshin me të në pranverën e vitit 1945. Në total u pyetën rreth 800

# OPERACIONI "MITI"

## HETIMI SEKRET I VDEKJES SË HITLERIT NGA BASHKIMI SOVJETIK



persona. Pasardhësi i Hitlerit, kishte bërë një shpallje publike se Fyhreri kishte vdekur duke luftuar në Berlin. Ky skenar i ngjarjeve u pranua vetëm nga pasuesit e Hitlerit (disa neo-nazistë e besojnë shumë). Por ai nuk i reziston hetimeve të Operacionit Miti. Përmes pyetjeve të tyre, ata kishin konstatuar sesi Hitleri ashtu edhe Eva aluduan për vetëvrasjen e tyre të afërt në muajin prill.

Ata patën marrë edhe deklaratën nga shumica e njerëzve të afërt me Hitlerin, që asokohe deklarorin se Fyhreri e qëllloi veten në anën e djathtë të kokës dhe u asgjësua nga njerëzit e tij. Ata arritën në përfundimin se kishin gjetur trupin e Hitlerit. Nga ana tjetër, kjo është ajo që ata donin të besonin gjithë të tjerët. Trupi që u nxorën nga gropa tek kopshti i Kancelarisë, është kandidati më i mundshëm për kufomën e Hitlerit. Mjerisht, kjo e fundit është rapor-

**Rusët ruajtën një cohën e shtratit të përgjakur mbi të cilin supozohej se qe shtrirë Hitleri kur qëllloi veten, si dhe një pjesë e kafkës. Analiza mjekoligjore e cohës nuk na jep asgjë, sepse të afërmit e Hitlerit nuk iu përgjigjen kërkesave të testit. Nga ana tjetër kafka u zbulua të ishte e një gruaje, nga një ekspert që punon për "History Channel". Operacioni Miti, nuk iu përgjigj realisht në mënyrë shteruese çështjes mbi vdekjen e Hitlerit**

tuar të jetë nxjerrë dhe rivarrosur disa herë, para se të shkatërrohej përfundimisht nën urdhrat e shefit nga KGB-së Juri Andropovi në vitin 1970. Sovjetikët ruajtën disa prova të trupit dhe vetëvrasjes.

Ata ruajtën një cohën e shtratit të përgjakur mbi të cilin supozohej se qe shtrirë Hitleri kur qëllloi veten, si dhe një pjesë e kafkës. Analiza mjeko-ligjore e cohës nuk na jep asgjë, sepse të afërmit e Hitlerit nuk iu përgjigjen kërkesave të testit. Nga ana tjetër kafka u zbulua të ishte e një gruaje, nga një ekspert që punon për "History Channel". Operacioni Miti, nuk iu përgjigj realisht në mënyrë shteruese çështjes mbi vdekjen e Hitlerit.

Megjithatë, sovjetikët besonin natyrisht se Hitleri vrau veten, dhe se ata përfundimisht zbuluan trupin e tij. Kjo është e besueshme për shumë arsye. Së pari, do të ishte e çuditshme për Hitlerin të luftonte në vijën e frontit në Berlin, duke e ditur se çfarë do të bënte më të Ushtria e Kuqe, në rast se e kapte të gjallë. Së dyti, nazistët e tjerë si Jozef Gëbelsi dhe gruaja e tij Magda, kryen vetëvrasje. Jozefi dhe Magda shkuan aq larg sa vranë më parë të 6 fëmijët e tyre. Kjo na tregon se qe vetëvrasja qe parë si më e preferueshme sesa kapja gjallë. Së fundmi, ka patur shumë pak mundësi që Hitleri të shpëtonte. Ai priti derisa Ushtria e Kuqe të ndodhej në prag të bunkerit të nëndheshëm. Neonazistët kanë një tendencë për ta pikturuar Hitlerin si një hero trim. Megjithatë, ai punësoi një sozi për të parandaluar vrasjen. A tingëlton kjo e përputhshme me llojin e njeriut që do të vdiste duke luftuar në vijën e pare të frontit?



Koha, e premte 5 janar, 2018

SHOQATA AKCIONARE PËR MENAXHIMIN E HAPËSIRAVE AFARISTE  
NË PRONËSI TË SHTETIT-SHKUPSHPALLJE nr. 1 për dhënie me qira të hapësirave afariste në pronësi të Republikës së Maqedonisë  
nëpërmjet ankandit elektronik publik (shpallje për herë të dytë)

## LËNDA E ANKANDIT ELEKTRONIK PUBLIK

Lënda e ankandit elektronik publik është dhënie me qira e hapësirave afariste në pronësi të Republikës së Maqedonisë, sipas pasqyrës Tabelare në të cilën janë paraqitur të dhëna për numrin e parcelës kadastrale dhe komunës kadastrale ku gjendet lokali, numri i fletës së pronësisë, hapësira e lokalit afarist(m<sup>2</sup>), komuna, adresa ku gjendet lokali afarist, etazhi dhe numri i lokalit afarist, çmimi total fillestar, garancia bankare për seriozitetin e ofertës, afati për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje në ankandin publik dhe koha e fillimit të ankandit publik.

Në bazë të nenit 4 nga Ligji për blerje dhe dhënie me qira të ndërtesave, dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 13/13, 69/13, 27/14, 42/14, 178/14, 180/14, 51/15 dhe 61/15, 129/15, 6/16 dhe 106/16), si dhe Vendimit të Bordit të drejtorëve të Shoqatës aksionare nr.02-2681/5 nga 01.09.2016, lëndë e ankandit elektronik publik është hapësira afariste në vijim:

## I. SHKUP

Numri rendor	Numri i Parcelës Kadastrale Komuna Kadastrale dhe Fleta e Pronësisë	Komuna, adresa, niveli, hyrja dhe numri i lokalit	Sipërfaqe (m <sup>2</sup> )	Vlera e përgjithshme e llogaritur e hapësirës afariste (në denarë)	Kostoja fillestare e qirasë mujore (në denarë pa TVSH)	Garancia bankare për seriozitetin e ofertës(2%)	Afati i fundit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje në ankand publik	Koha e fillimit të ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	42 K.Vodë 2 48106	Aerodrom Viladimir Komarov nr. 1/2-4 përdhese,hyrje 2,lokali 4	19,00	945.190,00	4.726,00	19.904,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	29.01.2018 ora 09:00
2	42 K.Vodë 2 41326	Aerodrom Viladimir Komarov sol. 1 përdhese,hyrje4,lokali 4	16,00	791.500,00	3.958,00	15.830,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	29.01.2018 ora 10:30
3	755/45 K.Vodë 2 41032	Aerodrom Pandil Shishkov nr.1 bodrum,hyrje1,garazhi 3,	15,00	528.600,00	2.643,00	10.572,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	29.01.2018 ora 12:00
4	755/45 K.Vodë 2 41032	Aerodrom Pandil Shishkov nr.1 bodrum,hyrje1,garazhi 6,	15,00	528.600,00	2.643,00	10.572,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	29.01.2018 ora 13:30
5	755/45 K.Vodë 2 41032	Aerodrom Kandil Shishkov nr.1 bodrum,hyrje1,garazhi 9,	18,00	629.600,00	3.148,00	12.592,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	29.01.2018 ora 15:00
6	838/2 K.Vodë 2 48246	Aerodrom Bul. Jane Sandanski nr.82 Q.T Biser Tarracë (nënçati), hyrje 1	94,00	3.555.432,00	17.777,00	71.109,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	30.01.2018 ora 09:00
7	315/6 K.Vodë 2 56903	Aerodrom Bul. K.J.Pitu nr.17 përdhese, hyrje 1,lokali 17	45,00	3.456.600,00	17.283,00	69.132,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	30.01.2018 ora 10:30
8	315 K.Vodë 2 49223	Aerodrom Bul. K.J.Pitu nr.17 përdhese, hyrje 1,lokali 21	18,00	1.437.600,00	7.188,00	28.752,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	30.01.2018 ora 12:00
9	315/1 K.Vodë 2 57183	Aerodrom Bul. K.J.Pitu nr.17 përdhese, hyrje 1,lokali 25	13,00	854.600,00	4.273,00	17.092,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	30.01.2018 ora 13:30
10	315/6 K.Vodë 2 56903	Aerodrom Bul. K.J.Pitu nr.17 përdhese, hyrje 1,lokali 26	13,00	854.600,00	4.273,00	17.092,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	30.01.2018 ora 15:00
11	315 K.Vodë 2 49046	Aerodrom Bul. K.J.Pitu nr.17 përdhese, hyrje 1,lokali 27	13,00	854.600,00	4.273,00	17.092,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	31.01.2018 ora 09:00
12	315 K.Vodë 2 48142	Aerodrom Bul. K.J.Pitu nr.17 përdhese, hyrje 1,lokali 31	27,00	1.843.200,00	9.216,00	36.864,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	31.01.2018 ora 10:30
13	315 K.Vodë 2 48733	Aerodrom Bul. K.J.Pitu nr.17 përdhese, hyrje 1,lokali 33	22,00	1.470.300,00	7.352,00	29.406,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	31.01.2018 ora 12:00
14	315 K.Vodë 2 49037	Aerodrom Bul. K.J.Pitu nr.17 përdhese, hyrje 1,lokali 37	27,00	1.843.200,00	9.216,00	36.864,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	31.01.2018 ora 13:30
15	315/6 K.Vodë 2 104083	Aerodrom Bul. K.J.Pitu nr.17 Hapësira ndërmjet katëve 1,hyrje 1, galeria 8	70,00	3.487.000,00	17.435,00	69.740,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	31.01.2018 ora 15:00
16	315/6 K.Vodë 2 104084	Aerodrom Bul. K.J.Pitu nr.17 tanepija,hyrje 1,lokali 7	79,00	3.935.400,00	19.677,00	78.708,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	01.02.2018 ora 09:00
17	879/8 K.Vodë 2 40781	Aerodrom Bul. V.S. Bato nr.1 përdhese, hyrje 1,lokali 1	27,00	1.494.500,00	7.473,00	29.890,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	01.02.2018 ora 10:30

## II. MANASTIR

Numri rendor	Numri i Parcelës Kadastrale Komuna Kadastrale dhe Fleta e Pronësisë	Komuna, adresa, niveli, hyrja dhe numri i lokalit	Sipërfaqe (m <sup>2</sup> )	Vlera e përgjithshme e llogaritur e hapësirës afariste (në denarë)	Kostoja fillestare e qirasë mujore (në denarë pa TVSH)	Garancia bankare për seriozitetin e ofertës(2%)	Afati i fundit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje në ankand publik	Koha e fillimit të ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	9
18	8346/1 Manastir 4 70895	Manastir 11 Mars sol.1 përdhese,hyrje1,lokali 3	21,00	741.400,00	3.707,00	14.828,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	01.02.2018 ora 12:00
19	2801 Manastir 4 70970	Manastir Ivan Milutinoviq nr.37 përdhese,hyrje1,lokali 5	86,00	4.784.500,00	23.923,00	95.690,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	01.02.2018 ora 13:30

## III. RESNJE

Numri rendor	Numri i Parcelës Kadastrale Komuna Kadastrale dhe Fleta e Pronësisë	Komuna, adresa, niveli, hyrja dhe numri i lokalit	Sipërfaqe (m <sup>2</sup> )	Vlera e përgjithshme e llogaritur e hapësirës afariste (në denarë)	Kostoja fillestare e qirasë mujore (në denarë pa TVSH)	Garancia bankare për seriozitetin e ofertës(2%)	Afati i fundit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje në ankand publik	Koha e fillimit të ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	9
20	4318 Resnje 57022	Resnje Josif Josifovski sol. 1 përdhese,hyrje1,lokali 1	59,00	3.723.500,00	18.618,00	74.470,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	01.02.2018 ora 15:00

## IV. NEGOTINË

Numri rendor	Numri i Parcelës Kadastrale Komuna Kadastrale dhe Fleta e Pronësisë	Komuna, adresa, niveli, hyrja dhe numri i lokalit	Sipërfaqe (m <sup>2</sup> )	Vlera e përgjithshme e llogaritur e hapësirës afariste (në denarë)	Kostoja fillestare e qirasë mujore (në denarë pa TVSH)	Garancia bankare për seriozitetin e ofertës(2%)	Afati i fundit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje në ankand publik	Koha e fillimit të ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	9
21	11905 Negotinë 6871	Negotinë Mareshali Tito nr.138 përdhese,hyrje1,lokali 1	16,00	959.400,00	4.797,00	19.188,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	02.02.2018 ora 09:00
22	8909 Negotinë 6871	Negotinë Mareshali Tito nr.146 përdhese,hyrje2,lokali 1	6,00	269.493,00	1.347,00	5.390,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	02.02.2018 ora 10:30
23	9751 Negotinë 6871	Negotinë Mareshali Tito nr.154 përdhese,hyrje1,lokali 1	5,00	202.830,00	1.014,00	4.057,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	02.02.2018 ora 12:00
24	9753 Negotinë 6871	Negotinë Mareshali Tito nr.188 përdhese,hyrje1,lokali2	28,00	1.344.150,00	6.721,00	26.883,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	02.02.2018 ora 13:30
25	8912 Negotinë 6871	Negotinë Partizanska nr.2 përdhese,hyrje1,lokali 6	18,00	770.200,00	3.851,00	15.404,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	02.02.2018 ora 15:00
26	8912 Negotinë 6871	Negotinë Partizanska nr.2 përdhese,hyrje1,lokali7	16,00	716.100,00	3.581,00	14.322,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	29.01.2018 ora 09:00

## V. KAVADAR

Numri rendor	Numri i Parcelës Kadastrale Komuna Kadastrale dhe Fleta e Pronësisë	Komuna, adresa, niveli, hyrja dhe numri i lokalit	Sipërfaqe (m <sup>2</sup> )	Vlera e përgjithshme e llogaritur e hapësirës afariste (në denarë)	Kostoja fillestare e qirasë mujore (në denarë pa TVSH)	Garancia bankare për seriozitetin e ofertës(2%)	Afati i fundit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje në ankand publik	Koha e fillimit të ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	9
27	12952 Kavadar 2 12839	Kavadar Bllagoj Kërshiq nr.3 përdhese,hyrje2,lokali 5	37,00	1.351.800,00	6.759,00	27.036,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	29.01.2018 ora 10:30
28	10737 Kavadar 2 12839	Kavadar Veljko Vllahoviq nr.4 përdhese,hyrje1,lokali4A	24,00	464.400,00	2.322,00	9.288,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	29.01.2018 ora 12:00
29	10737 Kavadar 2 12839	Kavadar Veljko Vllahoviq nr.4 përdhese,hyrje2,lokali4B	24,00	464.400,00	2.322,00	9.288,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	29.01.2018 ora 13:30

## VI. KËRÇOVË

Numri rendor	Numri i Parcelës Kadastrale Komuna Kadastrale dhe Fleta e Pronësisë	Komuna, adresa, niveli, hyrja dhe numri i lokalit	Sipërfaqe (m <sup>2</sup> )	Vlera e përgjithshme e llogaritur e hapësirës afariste (në denarë)	Kostoja fillestare e qirasë mujore (në denarë pa TVSH)	Garancia bankare për seriozitetin e ofertës(2%)	Afati i fundit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje në ankand publik	Koha e fillimit të ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	9
30	3088 Kërçovë 4 95192	Kërçovë 4 Korriku nr.188 përdhese,hyrje1,lokali 5	28,00	1.244.080,00	6.220,00	24.882,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	29.01.2018 ora 15:00

## VII. KOÇANI

Numri rendor	Numri i Parcelës Kadastrale Komuna Kadastrale dhe Fleta e Pronësisë	Komuna, adresa, niveli, hyrja dhe numri i lokalit	Sipërfaqe (m <sup>2</sup> )	Vlera e përgjithshme e llogaritur e hapësirës afariste (në denarë)	Kostoja fillestare e qirasë mujore (në denarë pa TVSH)	Garancia bankare për seriozitetin e ofertës(2%)	Afati i fundit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje në ankand publik	Koha e fillimit të ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	9
31	12035 Koçani 17061	Koçani Kej i Revolucionit sol. 1 përdhese,hyrje 3	44,00	2.390.300,00	11.952,00	47.806,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	30.01.2018 ora 09:00

## VIII. VINIÇË

Numri rendor	Numri i Parcelës Kadastrale Komuna Kadastrale dhe Fleta e Pronësisë	Komuna, adresa, niveli, hyrja dhe numri i lokalit	Sipërfaqe (m <sup>2</sup> )	Vlera e përgjithshme e llogaritur e hapësirës afariste (në denarë)	Kostoja fillestare e qirasë mujore (në denarë pa TVSH)	Garancia bankare për seriozitetin e ofertës(2%)	Afati i fundit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje në ankand publik	Koha e fillimit të ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	9
32	8702 Viniçë 6869	Viniçë Strasho Pinxhur sol.1 përdhese+tarracë,hyrje 2	60,00 3,00	1.092.000,00	5.460,00	21.840,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	30.01.2018 ora 10:30

## IX. MAKEDONSKA KAMENICA

Numri rendor	Numri i Parcelës Kadastrale Komuna Kadastrale dhe Fleta e Pronësisë	Komuna, adresa, niveli, hyrja dhe numri i lokalit	Sipërfaqe (m <sup>2</sup> )	Vlera e përgjithshme e llogaritur e hapësirës afariste (në denarë)	Kostoja fillestare e qirasë mujore (në denarë pa TVSH)	Garancia bankare për seriozitetin e ofertës(2%)	Afati i fundit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje në ankand publik	Koha e fillimit të ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	9
33	4238/1 Kamenicë 2248	Makedonska Kamenica Mareshali Tito srp.1 përdhese,hyrje 4	38,00	904.200,00	4.521,00	18.084,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	30.01.2018 ora 12:00

## X. DELLÇEVË

Numri rendor	Numri i Parcelës Kadastrale Komuna Kadastrale dhe Fleta e Pronësisë	Komuna, adresa, niveli, hyrja dhe numri i lokalit	Sipërfaqe (m <sup>2</sup> )	Vlera e përgjithshme e llogaritur e hapësirës afariste (në denarë)	Kostoja fillestare e qirasë mujore (në denarë pa TVSH)	Garancia bankare për seriozitetin e ofertës(2%)	Afati i fundit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje në ankand publik	Koha e fillimit të ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	9
34	6559/5 Dellçevë 8379	Dellçevë Kej Bregallnica sol.1 bodrum-1,hyrje 3	74,00	587.800,00	2.939,00	11.756,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	30.01.2018 ora 13:30
35	6559/5 Dellçevë 8379	Dellçevë Kej Bregallnica sol.1 bodrum-1,hyrje 4	18,00	170.100,00	851,00	3.402,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	30.01.2018 ora 15:00

## XI. KUMANOVË

Numri rendor	Numri i Parcelës Kadastrale Komuna Kadastrale dhe Fleta e Pronësisë	Komuna, adresa, niveli, hyrja dhe numri i lokalit	Sipërfaqe (m <sup>2</sup> )	Vlera e përgjithshme e llogaritur e hapësirës afariste (në denarë)	Kostoja fillestare e qirasë mujore (në denarë pa TVSH)	Garancia bankare për seriozitetin e ofertës(2%)	Afati i fundit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje në ankand publik	Koha e fillimit të ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	9
36	14788/1 Kumanovë 69961	Kumanovë Pionerska sol.1 përdhese,hyrje1,lokali1	33,00	1.464.400,00	7.322,00	29.288,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	31.01.2018 ora 09:00
37	10597 Kumanovë 69961	Kumanovë Done Bozhinov sol. 1 përdhese,hyrje1,lokali1	28,00	1.238.700,00	6.194,00	24.774,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	31.01.2018 ora 10:30
38	14273 Kumanovë 69961	Kumanovë Fetka Naskova sol. 1 përdhese,hyrje1,lokali 1	14,00	749.600,00	3.748,00	14.992,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	31.01.2018 ora 12:00
39	18680 Kumanovë 69961	Kumanovë Revolucionit i tetorit sol.1 përdhese,hyrje1,lokali 1	248,00	9.360.660,00	46.803,00	187.213,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	31.01.2018 ora 13:30
40	13860 Kumanovë 69961	Kumanovë Revolucionit i tetorit sol.1 përdhese,hyrje 1	41,00	1.918.185,00	9.591,00	38.364,00	20 ditë nga shpallja (25.01.2018)	31.01.2018 ora 15:00



# SHKËNDIJA FILLOI PËRGATITJET ME TRE FYTYRA TË REJA

Mbrojtësi 23 vjeçar Mevlan Adili vjen nga FC UTA Arad e Rumanisë, portieri 24-vjeçar Saladin Mustafi së fundmi ishte pjesë e Teteksit, ndërsa Sabit Bilali ka qenë pjesë e Renovës dhe Dinamo Zagrebit

Shkup, 4 janar - Skuadra e Shkëndijës është grumbulluar të mërkurën për herë të parë për vitin 2018, ndërsa ka rënë në sy prania e tre futbollistëve të rinj, Mevlan Adili, portieri Saladin Mustafi dhe Sabit Bilali. Mbrojtësi 23 vjeçar Mevlan Adili vjen nga FC UTA Arad e Rumanisë, ndërsa praktikisht rikthehet te Shkëndija ku ishte 6 muajt e parë të vitit 2015. Ai firmosi për 18 muajt e ardhshëm dhe pritjet të rrisë konkurrencën në repartin e mbrojtjes. "Klubi i ri, sfida të reja, KF Shkëndija", ka shkruar në profilin e tij zyrtar në "Facebook", Mevlan Adili. Ndryshe, portieri 24-vjeçar Saladin Mustafi ka nënshkruar për dy vite. Ka përvojë në Ligën e Parë të Maqedonisë, kur ka luajtur me Renovën, për të cilët përveç kampionatit, ka regjistruar edhe dy paraqitje në eliminatorët e Liga Evropës. Një periudhë të



Mevlan Adili



Sabit Bilali



Saladin Mustafi


shkurtër ishte pjesë e Llapit në Kosovë, ndërsa sezonin e fundit luajti me Teteksin. "Unë si tetovar jam krenar që do jem pjesë e Shkëndijës e cila është në zemrën e çdo Shqiptari. Do jap maksimumin tim dhe do luftoj për fanellën. Me përkrahjen e zjarrtë të 'Ballistëve', besoj dhe jam i bindur se do arrijmë caqet tona. Jam këtu që të bëj më të mirën për Shkëndijën", shkroi në profilin e tij zyrtar portieri 24-vjeçar. Derisa, përforcimi i tretë Sabit Bilali luan si mesfushor ofensivë, ndërsa ka qenë pjesë e Renovës dhe Dinamo

Zagrebit, ndërsa me Shkëndijën ka firmosur kontratë 3-vjeçare. Që të tret i janë bashkuar Shkëndijës dhe do të udhëtojnë drejt Antalias me skuadrën, për të kryer fazën përgatitore. Ndryshe, në Tetovë kuqezinjtë do të stërviten deri më 20 janar, ndërsa siç thamë më pas ekspedita do të udhëtojë në Antali, ku pos seancave stërvitore do të zhvillojë edhe katër ndeshje miqësore. Cekim, Shkëndija kryeson bindshëm kampionatin pas përfundimit të gjysmës së sezonit, teksa ka grumbulluar 46 pikë, tetë më shumë se Vardari ndjekës.



Qatip Osmani

Siç e dini Shkëndija filloi me përgatitjet. Disa lojtarë munguan me arsye dhe presim që edhe ata së shpejti të na bashkëngjiten. Besoj se deri në fund të javës do të jemi të kompletuar. Sa i përket planit të përgatitjeve deri më 9 janar do të stërvitemi në Tetovë, pastaj do të shpërngulemi në Ohër ku do të qëndrojmë deri më 16 janar. Në Ohër do të zhvillojmë edhe dy ndeshje kontrolluese, kurse më 20 janar do të shkojmë në Antalia të Turqisë ku do të zhvillojmë katër ndeshje kontrolluese. Pak a shumë Shkëndija ato lojtarë cilësor që janë i ka në ekip kështu që nuk ka nevojë për shumë përforcime. Do të mundohemi nëse na jepet rasti të marrim ndonjë lojtar me kualitet të madh



## Berisha në vend të Reinas

Napoli kërkon t'ia besojë portën Etrit Berishës. Pasi Atlanta arriti të eliminonte Napolin nga Kupa e Italisë mesa duket të dyja skuadrat do të përballen sërish. Këtë herë jo në fushën e blertë, por në tavolinën e rrumbullakët. Shkak është gardiani kuqezi, Etrit Berisha i cili jo në pak raste është shfaqur si asi nën mëngë për portën e Atalantës, ku me pritjet e tij ka ndihmuar shumë skuadrën.

Një gjë të tillë e vërtetoi edhe në sfidën ndaj Napolit. Drejtuesit e klubit jugor, kanë krijuar bindjen se ish-portieri Lacios është pasuesi ideal i Pepe Reinas me spanjollin që ka një kontratë që skadon në qershor.

Kjo nuk është hera e parë që prishtinaliu kërkohet nga skuadra ku luan dhe një tjetër lojtar kuqezi siç është Elseid Hysaj. Ekipi i drejtuar nga Maurizio Sarri tentoi të siguronte shërbimet e Berishës dhe sezonin e kaluar, por marrëveshja në fund nuk u arrit. Ndërkohë që këtë herë situata mund të marrë një tjetër rrjedhë.



## Zhuta më 12 janar kundër Hanter

Shkup, 4 janar - Boksieri i mirënjohur shqiptar Fatlum Zhuta, vitin 2018 do ta fillojë siç duket menjëherë me aktivitete sportive, pasi ai më 12 janar në Sietell të Uashingtonit, do të zhvillojë ndeshjen e tij të parë këtë vit edhe atë ndaj një boksieri me përvojë

të madhe Eddi Hanter. "Për këtë duel jam përgatitur gati 6 muaj, kam pasur edhe më herët disa oferta po të njëjtit anulonin ndeshjet për shkak lëndimeve. Por, kjo e 12 janarit është më zyrtare, kurse do ndeshem në Sietell ndaj një boksieri që se njoh shumë

mirë por e di që ka përvojë të madhe. Do të jap maksimumin që të arrij deri tek fitorja dhe të filloj vitin e ri pozitivisht", deklaroi Zhuta për "ArenaRing". Derisa, boksieri nga Struga pohoi se përgatitjet kryesisht është duke i zhvilluar në Alaska.

## KOSOVA PA TRAJNER, PA STADIUM DHE PA KUNDËRSHTAR PËR MUAJIN MARS

Kombëtarja e Kosovës ende nuk ka trajner të ri dhe nuk e di nëse do të luaj miqësore gjatë muajit mars, kur edhe janë data e lira nga FIFA shkruan "Koha Ditore". Në terminin e lirë të FIFA-s për miqësore të përfaqësueseve "A", ajo U21 do të luajë ndeshje eliminatorë, andaj në sta-

diumin "Adem Jashari" në Mitrovicë nuk bën të llogaritet. Stadium tjetër që plotëson kriteret nuk ka në Kosovë. Përfaqësuesja (U21) më 22 dhe 27 mars do t'i luajë dy ndeshje eliminatorë në Mitrovicë, kundër Azerbajxhanit dhe Gjermanisë. Po në këtë periudhë është edhe termini

për miqësore të përfaqësueseve "A". Kryetari i FFK-së, Fadil Vokrri, ka thënë se deri në fund të muajit shkurt Kosova do ta ketë zëvendësuesin e Albert Bunjakit. Sipas tij, tashmë kanë nisur negociatat me disa federata nacionale edhe për punën e kundërshtarit në miqësore.





# INTERI MUND TË BËJË MË SHUMË

Ne kemi fiksuar disa numra të mëdhenj, kemi bërë mirë, por kemi diçka më shumë në dispozicion. Ne nuk e kemi optimizuar forcën që kemi, prandaj në pjesën e dytë të sezonit do të duhet të kemi një marrsh më tepër", thotë Spaleti



Interi, në ndeshjen e tij të parë të vitit 2018, që gjithashtu përkon me gjysmën e parë të sezonit, do të jetë i angazhuar në fushën e Fiorentinës. Trajneri Luciano Spaleti, duke folur për mikrofonat e "Premium Sport", shpjegoi: "Në ndeshjet më të bukura të vitit duhet të bëni shfaqjen më të mirë, atë që vetëm futbollit mund ta ofrojë", tha Spaleti. Pavarësisht nga mënyra e mirë e ecurisë së Interit në përgjithësi, Spaleti nuk është i kënaqur. "Duhet të aspirojmë për të

bërë diçka ekstra. Kështu që nuk jam i kënaqur me punën time. Interi është diçka emocionale, e cila krijon pasion të vërtetë. Vetëm të shikojmë brenda historisë zikaltër dhe ne duhet të punojmë në mënyrë të tillë, që ta ndiejmë Interin brenda vetes. Mjafton të jemi Interi dhe kjo bën dallimin", shtoi më tej Spaleti. Sipas trajnerit toskan, Interi mund të kishte bërë edhe më shumë. "Ne kemi fiksuar disa numra të mëdhenj, kemi bërë mirë, por kemi diçka më shumë në

dispozicion. Ne nuk e kemi optimizuar forcën që kemi, prandaj në pjesën e dytë të sezonit do të duhet të kemi një marrsh më tepër". Spaleti ka analizuar edhe rënien e fundit të zikalterve. "Ne duam të fajsojmë një problem psikologjik, veçanërisht për faktin se nuk mund të shënojmë më. Por, nëse shikojmë të prekim disa çelësa, kemi nevojë për specialistë në të gjitha fushat. Psikologu i largimit nga goli është Ikardi. Unë do të flas me ekipin dhe do ta gjejmë zgjidhjen". Sesioni i

transferimit të dimrit ka ardhur. "Nuk pres asgjë. Kam një ekip të fortë dhe dy menaxherë të fortë, kështu që, nëse ka një shans për të mbyllur një operacion fitimprurës, ata do ta bëjnë. Ne po bëjmë mirë, kemi gjithçka për të bërë mirë". Spaleti shpjegoi edhe qëllimet e tij për vitin 2018. "Qëllimi im është gjithmonë të shoh 65 mijë njerëz në stadium. Nëse punojmë mirë, atëherë mund të shohim edhe 80 mijë. Tifozët do të jenë vendimtarë për ne", përfundoi trajneri i Interit.



## Essien me statujën më të keqe të mundshme

Ai është një nga lojtarët më të mirë të Afrikës në histori dhe tani është bashkuar me "klubin" e futbollistëve që kanë një statujë më të keqe të mundshme, si Ronaldo, Bejll, Messi, apo Maradona. Statuja e ish-lojtarit të Çellsit dhe Real Madridit, Mikael Essien, ka qarkulluar dendur në rrjetet sociale ditët e fundit, sepse, thonë, është shumë e vështirë për t'u parë.

## Valdes mbyll karrierën dhe rrjetet sociale

Dëmtimi në ndeshjen me Selta Vigo në vitin 2014 kompromentoi përfundimisht karrierën e tij. Këputja e krociasit të ligamentit të gjurit të djathtë, bëri që Viktor Valdes të humbasë vendin në skuadrën më të bukur dhe fortë të futbollit evropian. Ish-portieri ekstrem i Barcelonës nuk e harron kurrë atë ndeshje, atë ditë, atë moment. Në vitin 2014 u fikën projektorët për atletin spanjoll, që deri në atë moment kishte shënuar një karrierë brilante, pjesë e një prej skuadrave që shkruajtën historinë e futbollit. Tanimë në moshën 35-vjeçare,

Valdes ka vendosur të tërhiqet përfundimisht nga futbollit, e ndërkohë të ndërpresë edhe komunikimin në rrjetet sociale, duke sjellë edhe një herë në kujtesë deklaratën e tij pas rikthimit nga dëmtimi, se "nuk më pëlqen fama dhe shpresoj që kur të fiken dritat, të mos më gjejnë". Pas dëmtimit në vitin 2014, Valdes u largua nga Barcelona për të provuar një eksperiencë të shkurtër te Mançester Junajted, që fillimisht e lëshoi me huazim te Standard Liezh, e sezonin e shkuar u bë pjesë e Midëllzboro.



## Sampdoria blen stadiumin "Ferraris"



Ideja e disa muajve më parë ishte që Sampdoria dhe Xhenoa të bëheshin bashkëpronarë në blerjen e stadiumin "Ferraris" të Xhenovës, por duket se skuadra "griffone" ka vendosur të tërhiqet. Për pasojë, skuadra e Sampdorias ka vijuar në idenë e saj për të pasur një stadium të vetin dhe presidenti Massimo Ferrero është gati të paguajë shumën prej 10 milionë

eurosh të vendosur nga komuna për të blerë stadiumin e vetëm të qytetit bregdetar. Komuna ka nxjerrë në shitje stadiumin dhe presidenti i Sampdorias është gati të investojë fillimisht duke paguar shumën e caktuar dhe më pas në rregullimin e brendshëm të këtij impianti sportiv. "Ne e duam një stadium për veten tonë dhe jemi gati të investojmë kudo që komuna ka dëshirë", tha Ferrero, që duket se nuk do të lërë këtë shans t'i ikë nga duart, për të blerë stadiumin legjendar. Çka do të thotë që skuadra tjetër e qytetit, Xhenoa, do të duhet të paguajë qira për të luajtur në stadiumin e shtëpisë.

## SPORT SHKURT

### Arsenali pret ofertën e Sitit për Sançezin

Tek Arsenali, Aleksis Sançez konsiderohet pothuajse i larguar dhe drejtuesit presin vetëm ofertën nga Mançester Sity për lojtarin, i cili është në fund të kontratës me "topçinjtë". Duke parë situatën klubi ka nisur punën për pasuesin e kilianit, i cili pritet të jetë Pierr-Emerik Aubamejang, me këtë të fundit që ka prishur raportet me Borussia Dortmundit. Me një ofertë prej 40 milionë eurosh Dortmundi do të pranonte largimin e Aubamejang ndërsa Arsenali do të kishte pasuesin ideal të Sançez, por do të zgjidhte edhe problemin me sulmin dhe me lojtarin rebel që nuk pranoi të rinovonte kontratën.

### Kepa nënshkruar për Realin

Kepa Arrizabalaga tashmë ka nënshkruar kontratën, që e lidh atë me Real Madridin. Sipas "AS", në edicionin e tij të së enjtes, dokumenti i nënshkruar përfshin dy datat e fillimit: janar dhe qershor 2018. Arsyeja është e thjeshtë. Ekipi i bardhë donte që Zidane të vendoste kur erdhni ndërkombëtarit spanjoll. Gjithçka tregon se Kepa do të jetë një lojtar i bardhë në këtë merkato të transferimit. Situata e tij te AtletiK është shumë e pakëndshme, që kur largimi i tij, tani, ose në qershor, është një sekret i hapur dhe tifozët nuk e falin atë. Gjithçka varet nga Real Madridi, pasi ai duhet të paguajë klauzolën prej 20 milionë eurosh, me të cilën dalja e portierit është fikse. Portieri ende do të ketë nevojë për 10 ditë të tjera, për të qenë 100 për qind, dhe ekipi i Real Madridit nuk dëshiron ta kryejë operacionin deri në atë moment.

### 20 mln euro për mbrojtësin e Lill

Pasi doli nga zona e ftohtë e renditjes, Kristal Pallas po punon për t'u larguar sa më shumë asaj. Kështu, klubi anglez është duke u treguar mjaft aktiv në merkato, ku kërkon të përforcohet veçanërisht në repartin e mbrojtjes. Plot 20 milionë euro ka ofruar Kristal Pallas, për të marrë shërbimet e mbrojtësit 23-vjeçar të Lill, Ibrahim Amadou. Ky i fundit është një futbollist mjaft interesant, i zbuluar nga Bielsa dhe që ka treguar një formë në rritje të vazhdueshme. Me Amadou, Pallas kërkon t'i zgjidhë telashtet për mbrojtjen, trajnerit Roj Hodxhson, i cili vazhdimisht është ankuar për problemin dhe mangësi në prapavijë.

**DASHI** 21. mars - 20. prill

Do i mërzhitin tej mase detyrimet ne çift gjate kësaj dite dhe do kërkon me shume liri e pavarësi. Do bënit mire te flisnit qetësisht me partnerin pa e acaruar atmosferën. Beqaret do kenë mundësi vetëm për aventura, asgjë me tepër sesa aq. Ne planin financiar fati do jete ne anën tuaj. Do kryeni shpenzimet me te domoshme dhe situata do mbetet e qëndrueshme.

**DEMI** 21. prill - 21. maj

Sektori i dashurisë do jete shume i privilegjuar gjate kësaj dite dhe çdo gjë do shkoje me se miri ndërmjet jush dhe partnerit. Thashethemet e te tjerëve nuk do ndikojnë aspak ne lidhjen qe keni krijuar. Beqaret jo vetëm qe do kenë takime, por mund te fillojnë edhe lidhje pasionante. Ne planin financiar do jete dite pozitive dhe do kryeni investimet e nevojshme.

**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Dite përgjithësisht e trazuar dhe e mbushur me vështirësi te shumta kjo e sotmja. Nuk do bini ne një mendje me partnerin dhe kjo do sjelle debate. Nëse jeni ende beqare duhet te mendohe ni mire para se t'iu jepni përgjigje propozimeve qe do iu bëhen. Sektori i financave do ketë vështirësitë e veta. Tregohuni me vigjilente dhe mos hidhni hapa te nxituar.

**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Do jeni shume te shqetësuar për ecurinë profesionale gjate kësaj dite dhe nuk do i kushtoni vëmendjen e duhur personit qe keni ne krah. Nëse ai do jete me humor te mire do iu kuptoje, ne te kundërt do keni goxha debate. Beqaret do kenë dashuri me shikim te pare dhe do iu duket vetja sikur janë ne ëndërr. Financat do jene te paqëndrueshme dhe mjaft delikate.

**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Mundohuni te mos konkurrioni gjate gjithë kohës me atë qe keni ne krah sot dhe te mos e ktheni lidhjen qe keni krijuar ne një mjedis boksi. Do i bënit keq vetes dhe atij qe keni ne krah. Beqaret do ngelen serish vetëm dhe kjo do i vraste paksa shpirtërisht. Ne planin financiar nuk pritet as problemi me i vogël kështu qe do jeni te qete. Ruajeni sa me gjate këtë situatë.

**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Do kuptoheni me se miri me partnerin tuaj gjate kësaj dite dhe lidhja juaj do ece me ritme me te shpejta. Ka mundësi qe ata qe kane shume kohe bashke te mendojnë një bashkëjetesë. Për beqaret nuk është koha e duhur për te filluar histori dashurie. Prisni edhe pak kohe. te ardhurat do fillojnë te rriten dalëngadalë. Vazhdoni t'i menaxhoni me kujdes dhe maturi ato.

**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Do jeni shume te nxituar gjate kësaj dite dhe ka rrezik te bëni gabime te pafalshme ne jetën e çiftit. Partneri nuk do iu fale kollaj dhe situata mund te dale jashtë kontrollit. Beqaret do kenë takime pa fund dhe do kenë mundësitë te bëjnë zgjedhjet e duhura. Buxhetin mund ta stabilizoni me pak me tepër maturi dhe kujdes. Ambienti yjor do jete mjaft i favorshëm.

**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Me ne fund një klime e ngrohte dhe harmonike do mbi-zotërojë ne jetën tuaj ne çift. Komunikimi ndërmjet jush dhe partnerit do jete i mire dhe nuk do bëni asgjë pa marre mendimet e njeri-tjetrit. Beqaret nuk do mund te qëndrojnë indiferente përballë personave qe do iu dalin para. Te ardhurat do fillojnë te rriten pak nga pak dhe kjo do iu beje te ndiheni me mire.

**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Surprizat d jene te shumta gjate kësaj dite ne jetën tuaj ne çift. Partneri do jete gati te beje gjithçka qe ju te ndiheni sa me mire dhe pasioni te rindizet. Beqaret nuk duhet te nxitohen për asgjë. Është e thjeshte te krijosh një lidhje, por është e vështirë te gjeshe personin e duhur për te kaluar jetën. Sektori i financave do ketë disa përmirësime. Mund te kryeni edhe ndonjë shpenzim me tepër.

**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Do ëndëroni me shume sesa duhet ne jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite dhe realiteti do jete mjaft zhgënjyes. Asgjë nuk do shkoje ashtu si e kishit menduar. Beqaret do vazhdojnë te jene ne kërkim te princit te kaltër, por nuk do e gjejnë ende atë. Ne planin financiar duhet te merrni masa strikte nëse nuk doni te ngeleni pa asnjë para ne xhep. Situata do jete e paqëndrueshme.

**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Jeta ne çift do jete shume e bukur gjate kësaj dite. Do ndiheni mire pranë atij qe keni ne krah dhe do filloni te bëni plane për te ardhmen se bashku. Beqareve do iu ndodhe diçka e çuditshme me një person te cilin e kane njohur prej vitesh. Ndjenjat për te do jene shume te forta sot. Fatmirësisht ne planin financiar nuk do ketë vështirësi, megjithatë shpenzimet duhet te vazhdoni t'i kryeni me maturi.

**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Se bashku me partnerin tuaj do ndërtoni mure te forta sot ne mënyrë qe ta mbron lidhjen qe keni krijuar nga çdo armik i jashtëm. Te dy do jeni ne njëmendje për gjithçka. Beqaret do kenë njohje interesante, por do ngurrojnë te krijojnë lidhje. Plutoni do ndikojë negativisht ne sektorin e financave dhe mund te sjelle probleme. Tregohuni shume me te kujdesshëm se me pare.

**shumë i lehtë**


6	9	2		4	5	3
			3			
	2				1	
8		3	4			1
	6	7		9		4
4			6	2		8
		6			8	
			9			
5	4	8		1	2	9

**SOT MË 5 JANAR BËHET NJË VIT NGA NDARJA E BASHKËSHORTES, NËNËS DHE GJYSHES TONË TË DASHUR**



**DAVJE MARKU**  
1950-2017

Jeta pa ty është shumë e rëndë. Assesi të pajtohem se ti nuk je në mesin tonë. Dita ditës kujtimet shtohen dhe ato kurrë nuk veniten. Ishe gjithçka për ne. Jemi krenarë që të patëm. Përherë do të jetosh në zemrat tona, më e shtrenjta jonë. **Të përkujtojnë përjetë - bashkëshorti Tahiri, fëmijët Arbeni, Fatimja, Largona dhe Kreshniku si dhe nipërit dhe mbesat**



Mensur Mamuti	FLOKË ARTIFICIALE PROJEKTI I BRSS-SË ME FLUTURAKUN "LUN" NE FOTO	P	LEXIMI I KURANIT GJATE FALJES I BRSS-SË, MISIONI NE FOTO	K	
FUTBOLLISTI ARGJENTINAS, LIONEL PASQYRË (ANG.)					
<b>M</b>					
SHTRESA PREJ LLAÇI QË I VIHET PËRËPËR MURIT DHE TAVANIT					
LARGIM NGA SHTEPIA					
OKSIGJENI KRYENEÇËSI		EDMOND TUPJA FUTBOLLISTI MAROKAN, SEJFEDIN			
<b>I</b>				LODH SHUMË	
PARAARDHËSI YNË NUMRI I LUDOLFIT					
<b>KOHA</b>	LLOJ GJARPRI HELMUES	FLORI	EMRI I (PLANETIT TË RI) SATELITIT NE FOTO (ËNDRRA)	PEREMER VETOR	E MOSHUARA GRADE, SHKALLË (SH.)
ELEMENT KIMIK (SA)					
ISHULL NE GREQI					ISH FUTBOLLISTI HOLANDEZ, HOLEJIS ISH FUTBOLLIST SPANJOLL
RUMANIA		AKTORI YNË I TEATRIT, ERMAL ISH FUTB. GJERM, HENES			NOTE MUZIKORE EKIP
DALJA E TOPIT JASHTË FUSHE				PJESË E KEMBES NATASHA SELA	LLOJ QYTEZË NE SLOVENI
EMERTIMI I STAEJTI LUNA, PAS VENDOSJES NDERMJET TOKËS DHE MARSIT					
DERR			PJESË E LULES (SH.)		

ZGJIDHJET: P, K, MESI, MIRROR, SUVA, IKJE, O, ET, INAT, ILIR, PLAKA, SAMARIUM, S, KRETA, NIEK, R, ÇANGA, LA, AVT, GJU, TIP, PLANETI I RI, THI, STIGMAT.

# "QENI TRUMP" ZËVENDËSON "GJELIN TRUMP" NË KINË

Ndërsa e gjithë bota pret vitin 2018, në Kinë nis viti i qenit dhe një qendër tregtare në qytetin Taiyuan në provincën Shangxi vendosi ta mirëpresë me një statujë gjigante të një qeni, të frymëzuar qartësisht nga presidenti amerikan Donald Trump. Si pjesë e festimeve të ardhjes së vitit të ri, qeni, i cili në kulturën kineze nuk është aspak ofendim, zëvendëson statujën e një vitit më parë të një gjeli që ngjante po me Trump. Sigurisht që statujës së qenit s'mund t'i mungonin tiparet e famshme të presidentit amerikan, kreshta e artë e flokëve, një kollare e kuqe, megjithëse jo aq e gjatë sa ajo reale që mban Trump dhe mbi të gjitha gishti tregues lart, shenja e politikës 'Amerika vjen e para'.



## Pse kumarxhinjtë nuk mund ta lënë bixhozin

Nëse keni luajtur bixhoz ndonjëherë, mund të keni vënë re se një humbje e ngushtë ju bën të doni ta vazhdoni lojën. Ky është vetëm një shembull nga keqinterpretimi i fitimit, të cilin njerëzit shpesh e bëjnë në kazino. Një tjetër: nëse e zeza hidhet pesë herë rresht, e kuqja duhet të "dalë" - apo jo? Gabim. Tani, shkencëtarët mendojnë se e kanë identifikuar mekanizmin në tru i cili i nxit kumarxhinjtë problematikë të bëjnë shtrembërime të tilla konjunktive më shumë se të tjerët. Ata kanë zbuluar se njerëzit tek të cilët insula - zona e trurit që luan një rol

kyç në emocione - ishte e dëmtuar, nuk joshen të vazhdojnë lojën pas humbjeve të ngushta ose pas një vargut të fatit të kuq ose të zi. Të gjitha grupet e tjera të pjesëmarrësve - duke përfshirë edhe pacientët me dëmtime në pjesët e tjera të trurit, si dhe pjesëmarrësit e shëndoshë - ishin joshur. "Bazuar në këto rezultate, ne besojmë se insula mund të jetë hiperaktive tek kumarxhinjtë problematikë, duke i bërë ata më të ndjeshëm ndaj këtyre gabimeve të të menduarit", tha dr. Luke Clark nga Universiteti i Cambridge, studiuesi kryesor i studimit të publikuar në PNAS. "Trajtimet e ardhshme për varësinë nga bixhozi mund të kërkojnë ta reduktojnë

këtë hiperaktivitet, ose përmes ilaçeve ose me teknika psikologjike si terapia e ndërgjegjshmërisë". Hulumtimet e tjera kanë treguar se kumarxhinjtë problematikë janë të prirë për këto keqinterpretime të njohura si "falsitete të kumarxhinjve". Bixhozçinjtë problematikë përbëjnë rreth 2.3 për qind të popullsisë në Shtetet e Bashkuara. Bixhozi problematik tani është klasifikuar si një varësi e sjelljes nga Shoqata Psikiatrike Amerikane.



## Shfarosja e 6-të e Tokës ka nisur

Thuajse i gjithë komuniteti i shkencëtarëve është në një mendje; në Tokë gjallesat janë shfarosur plot pesë herë në miliona vite ekzistencë të planetit tonë. Por, ajo që ndan ata është për shfarosjen e gjashtë. Shumë thonë se nuk ka nisur ende, e po kaq deklarojnë se shfarosja e gjashtë në masë në planetin tonë ka nisur prej disa vitesh tashmë. Grupit të dytë i përket studimi i një ekipi shkencëtarësh të publikuar në revistën "Proceedings of National Academy of Sciences". Në këtë studim kanë marrë pjesë mbi 200 shkencëtarë në mbarë botën, që u bënë bashkë për të studiuar elementët kryesorë që karakterizojnë, sipas tyre, nisjen e shfarosjes. Një prej këtyre elementeve është edhe shumëllojshmëria e gjallesave. Sipas tyre, shumë specie që deri para pak vitesh ishin

nën kërcënim, tani ose janë zhdukur, ose pritet të zhduken brenda një kohe të shkurtër. "Situata është aq keq sa do të thoja që nuk është etike të mos përdorim fjalët përkatëse dhe fjalët përkatëse në këtë rast janë; shfarosja ka nisur", thotë profesori mexikan Gerardo Ceballos. Ai thotë se specie të ndryshme po zhduken

me një shpejtësi shumë herë më të madhe se miliona vite më parë dhe kjo është shqetësuese. Shkencëtarët fajësojnë për këtë mbipopullimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore nga njeriu.



KALENDARI HISTORIK 5 JANAR

1349 - Margarita e Bavarisë emëron djalin e saj Willem V kont të Hollandës.

1463 - Poeti francez Francois Villon syrgjynoset nga Parisi.

1500 - Trupat e Dukës Ludovico Sforza ripushtojnë Milanon.

1757 - Dështon tentimi i vrasjes së Mbretit francez Luigji XV.

1809 - Nënshkruhet Traktati i Dardaneleve mes Britanisë dhe Francës.

1859 - Lundron anija e parë me avull mbi Lumin e Kuq.

1909 - Kolumbia pranon pavarësinë e Panamasë.

1911 - Portugezët dëbojnë Jezuitët.

1916 - Austro-Hungaria sulmon Malin e Zi.

1933 - Fillon ndërtimi i Urës Golden Gate.

1973 - Mali & Nigeria ndërpresin marrëdhëniet diplomatike me Izraelin.



Duhani u soll pas Luftës së Dytë Botërore nga SHBA-të në Evropë. Nikotina (helm përbërës i duhanit) emrin e mori nga një diplomat francez Jean Nicote, i cili e zbuloi atë dhe në nder të tij e mori edhe emrin Nikotinë.



A E DINI SE...

Kurora është simbol i vendeve me sistem monarkik në botë, që mbahet nga mbretëresha dhe që mbartet brez pas brezi në këto vende. Kurora për herë të parë u mbart nga mbretëresha e parë në Egjipt NEFERTITI, gruaja e faraonit Akhenaton. Poashtu, ky çift njihet edhe për ndërtimin e tempullit të parë monotheist në botë, me emrin AL-AMARNA.



### FËMIJA DUKE QARË

Një njeri duke udhëtuar sheh një fëmijë duke qarë dhe:

- Çka ke xhaxhit që po qanë?

- Më ka humbur 1 euro!

- Ja merre 1 euro nga unë!


Pastaj fëmiju fillon të qajë edhe më shumë.

- E çka ki që po qanë tani?

- Po të mos e kisha humbur 1 euro, tani do ti kisha 2 euro!



THËNIA E DITËS



Bota është një vend i rrezikshëm për të jetuar, jo për shkak të njerëzve që janë të ligj, por për shkak të njerëzve që nuk bëjnë asgjë për këtë.

(Albert Anjstajni)